

**Sot nisin
negociatat**
Optimizëm
për emrin

Fq.3



**INVESTIMET
E HUAJA**

140 milionë
euro më pak

Fq.7



**Ramadani,
djali që
fluturon
mbi ujë**

"Liria"

Fq.19



Koha

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3241 · e hënë 11 dhjetor 2017

-2°C | +10°C

15 DEN



**Jerusalmi pret
zgjidhje prej
një shekulli**

Fq.15

EDITORIAL

**Duhet ta
emërojmë
"ditën pa
emër"**



Jo një herë është dëshmuar se filmat me të suksesshëm në historinë e këtij arti kanë qenë filmat që realizuar mbi bazën e ngjarjeve të vërteta. Filmi, si vepër artistike, ka fuqi të jashtëzakonshme, sa që me të drejtë thuhet se filmi është industri në vete. Por, gjithashtu jo një herë është dëshmuar se...

Fq.2

GLOBI

**Grindja për
Jerusalemin
numëron të
vdekurit**

Fq.17

RAJON

**COSA
NOSTRA
ka ngritur
një bazë në
Shqipëri**

Fq.16



BESA DHE ASH FILLOJNË PËRGATITJET PËR KONGRESE ZGJEDHORE

FILLON GARA PARTIAKE



Përderisa Lëvizja BESA ka caktuar datën 24 shkurt të vitit të ardhshëm për mbajtjen e Kongresit zgjedhor, Aleanca për Shqiptarët pritet që garën partiake të fillojë në pranverë, por datën e saktë për mbajtjen e Kongresit pritet ta caktojë Kuvendi Qendror në mbledhjen e radhës më 25 dhjetor

Fq.4

Shqiptarët, talentë të pa akredituar

Shkup, 10 dhjetor - Jo të gjithë ata të cilët kanë aplikuar dhe jo të gjitha kategoritë e bursave do të ndahen këtë vit në lartësinë e paraparë me konkurset përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH). Në raste të caktuara ka pasur tejkalim të numrit të paraparë të bursave, sikurse është kategoria për nxënësit e talentuar të shkollave të mesme, ashtu siç ka kategori të tjera, ku numri i nxënësve që kanë

aplikuar është poshtë numrit të bursave që MASH kishte vënë në dispozicion. Por, marrë në total, për gjashtë kategoritë e bursave për vitin shkollor 2017/2018, numri i aplikimeve është më i madh se numri i planifikuar, ndërsa është goxha më i ulët numri i bursave të fituara. Në bazë të listave që MASH ka publikuar pasditën e së enjtes, për 745 bursat në dispozicion të nxënësve të shkollave, në të...

Fq.6



EDITORIAL

DUHET TA
EMËROJMË
"DITËN PA EMËR"

Shkëlzen HALIMI

Jo një herë është dëshmuar se filmat me të suksesshëm në historinë e këtij arti kanë qenë filmat që realizuar mbi bazën e ngjarjeve të vërteta. Filmi, si vepër artistike, ka fuqi të jashtëzakonshme, sa që me të drejtë thuhet se filmi është industri në vete. Por, gjithashtu jo një herë është dëshmuar se filmi, për qëllime të caktuara, është keqpërdorur, në veçanti kur intenca ka qenë që të paraqitet një e vërtetë e një regjimi të caktuar.

Diçka e tillë, fatkeqësisht, edhe me mjete të shqiptarëve (nga Buxheti i Maqedonisë), është bërë në Maqedoni, me filmin "Kur dita nuk ishte emër", në regji të Teona Mitevaska, film ky që për motiv pati vrasjen e pesëfishtë në liqenin e Smilkovës, të cilën ish Qeveria e kodoi si rasti "Monstra". Ky film që u xhirua pothuaj në heshtje, pati shumë pjesëmarrje në festivale të ndryshme anekënd botës. Pavarësisht se shumica e shqiptarëve nuk e kanë parë këtë film, realisht mund të marrin me mend se për çfarë bëhet fjalë. Kjo është njëra anë e medaljes.

Në ndërkohë, protagonistët e rastit "Monstra", të cilët qenë dënuar me burg të përjetshëm, tani mbrohen në liri. Të gjithë ata që i dëgjuan rrëfimet e tyre, për atë se çfarë kishin përjetuar gjatë trajtimit çnjerëzor, me siguri se kanë qenë të prekur tejmasë. Rrëfimet e tyre janë një lëndë e mjaftueshme për ta treguar anën tjetër të medaljes, por edhe për ta bërë një film real dhe për t'i treguar botës se deri ku shkojnë mostrat politike, që akoma nuk i kanë shfryer sa duhet epshet e tyre të urrejtjes ndaj qenies shqiptare.

Nëse shteti në mënyrë indirekte, përmes filmit "Kur dita nuk ishte emër", tentoi ta paraqesë të vërtetë e saj ndaj shqiptarëve, atëherë perse ne, shqiptarët, të mos e paraqesim të vërtetën jo ndaj shtetit, por ndaj mostrave që ishin në krye të këtij shteti, që (edhe përmes një filmi të turpshëm) u munda ta fshehtë "diellin me shoshë". Shoqëria shqiptare në Maqedoni, i pëlqeu dikujt apo jo, tani është e obliguar që botës t'ia tregojë të vërtetën e këtij rasti. Lënda e filmit është e mjaftueshme, kemi skenaristë, aktorë e regjisorë dhe nuk duhet të presim asfara lëmoshe nga Fondi i Filmit apo ndonjë kooproduksion tjetër, sepse ne kemi një komunitet të madhe të biznesmenëve, të cilët janë në gjendje të ndajnë mjete të mjaftueshme për bërjen e një filmi në dedikim të atyre që përjetuan golgotë të vërtetë në burgjet maqedonase. Nëse disa nga biznesmenët shqiptarë kanë mundësi të ndajnë mjete për këngëtarë serbë maqedonas, apo për ngjarje të ndryshme kulturore, ku nuk janë të përfshirë shqiptarët, atëherë shpresojmë se kjo ngjarje do t'i motivonte që pa hezitur të ndajnë mjete për realizimin e një projekti me taban kombëtar.

Sepse ditës që nuk kishte emër, si shoqëri shqiptare, e kemi për borxh t'i lëmë emrin e vërtetë që i takon...

KAUZAT E HUAJA

"Nëse shqiptarët duhet të marrin shembull diçka prej palestinezëve atëherë duhet të marrin shembull vendosmërinë e tyre për të mbrojtur kauzën e tyre dhe jo kauzat e huaja dhe unitetin që kanë muslimanët dhe të krishterët palestinezë mes vete", shkruan dr. Artan Dika në profilin e tij në Facebook.



KUMANOVA E KAZINOVE

"Në qendër të vëmendjes, CASINOT në Kumanovë... Kësaj radhe 'jabanxhinjtë' e paskan vendosur të stacionohen edhe te tregu i gjelbërt, ku kalojnë fëmijë, nxënës, studentë, arsimtarë dhe intelektualë të ndryshëm. He moj Kumanovë e vuajtur, e shtypur dhe e lënë nën mëshirën e kohës, po ti a nuk meriton të kesh më shumë respekt?! Ne kemi nevojë për rehabilitim, rehati, paqe dhe qetësi. Duam që përballë syve të fëmijëve tanë të mos duken ndriçimet ekstreme te kazinove, sidomos te tregu ku qarkullojnë fëmijët tanë... Aty nuk ka vend për bixhoz, për rrahje, për urrejtje, për humbje dhe për ndarje nga fëmijët dhe familja. Jo Kumanovë, jo! Ti meriton hapje të çerdheve, shoqatave edukative, ambulanca, por edhe shitore të nevojshme... Hapni vende pune, JO KAZINO në Kumanovë... STOP KAZINOVE!", shkruan gazetari dhe aktivisti Agim Behluli në profilin e tij në Facebook.



O PËR QIND KORRUPSION

"Kollaj e ka Zoran Zaevi të thotë: 'o për qind korrupsion'. Mjerë ata që janë te 1-shi, te 10-ta, te 100-shi i korrupsionit që kanë bërë partitë e mëparshme në pushtet... Atëherë?!", shkruan gjuhëtari Nazif Zejnullahu.



ËNDRRA PËR SHTET

"Ekziston një ndjenjë e vogël te disa shqiptarë për me pas një shtet, një copë shteti, madje dhe një copë shteti që ua vjedhin përditë. Unë vetë do të jem për atë shtet që tërë shqiptarëve u vjen si e drejtë. Ëndrra e disave është vogëlsia. Ëndrra ime është e kundërta. Jo madhësia, por drejtësia. Drejtësia ndaj shqiptarëve, drejtësia në mendjen e shqiptarëve", shkruan publicisti nga Tirana, Elvis Hoxha



KARRIGIA E PUSHTETIT

"Rregulli, ose tradita e shqiptarëve kudo ku janë autoktonë e do që pakica e cila kap karrigen e pushtetit synon të mos ta lëshojë kurrë më atë karrige, dhe ta përjashtojë, ta ofendojë, ta burgosë, ta shtypë, shumicën. Ndaj s'ka pse befasohet kush kur të përjashtuarit, domethënë njerëzit, e duan Albin Kurtin, përjashtimin nga rregulli. Jo pse është i bukur e i pushtetshëm, por pse është dinjitoz dhe konsistent në shtyrjen përpara të dytre ideve që u shërbejnë të shtypurve e të përjashtuarve", shkruan publicisti nga Tirana, Arbër Zaimi.



MEDIACitate

Presidenti francez vlerësohet me Çmimin e qytetit të Ahenit Karli i Madh për vitin 2018 për merita në unitetin e Evropës. Macron vlerësohet për "vizionin e një Evrope të re dhe rithemelimin e projektit evropian".

"Dy aspekte na kanë nxitur të vlerësojmë presidentin francez", deklaroi kryebashkiaku i Ahenit Marcel Philipp për përzgjedhjen e Emmanuel Macron-it për Çmimin Karli i Madh 2018. Në radhë të parë "angazhimi i tij për unitetin evropian dhe lufta e vendosur kundër çdo forme nacionalizmi janë shembullore dhe udhërrëfyese".

(DW, 10 dhjetor)

Rusia ka reaguar ndaj akuzave të Shteteve të Bashkuara se Moska është duke shkelur kushtet e një traktati të rëndësishëm të Luftës së Ftohtë për armët. Zëvendësministri i Jashtëm rus, Sergei Ryabkov, nëpërmjet një deklarate ka thënë, se "akuzat janë absolutisht të pabazuara". Kjo deklaratë ka ardhur vetëm një ditë pasi Shtetet e Bashkuara kanë thënë se do të ndërmarrin masa ekonomike dhe ushtarake kundër Moskës, si përgjigje ndaj mosmarrëveshjeve tensionuese rreth një rakete ruse, të cilën Uashingtoni e konsideron si shkelje të Traktatit për Forcat Atomike me Rreze të Mesme Veprimi (INF).

(REL, 10 dhjetor)

Ministrat e Jashtëm të Ligës Arabe gjatë një takimi në Egjipt, e kanë dënuar vendimin e presidentit të Shteteve të Bashkuara, Donald Trump për njohjen e Izraelit si kryeqytet të Jerusalemit. Në një deklaratë të lëshuar sot, ministrat arabë e ka cilësuar vendimin, "të paligjshëm" dhe u kanë bërë thirrje liderëve të vendeve të tyre, që më urgjencë të diskutojnë për çështjen e Jerusalemit. Ata kanë propozuar që mbledhja të mbahet në Jordani. Trump ka njoftuar më 6 dhjetor se Shtetet e Bashkuara e njohin zyrtarisht Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit dhe ka premtuar se Ambasada amerikane do ta bart nga Tel Avivi në Jerusalemin.

(TV Klan, 10 dhjetor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

SPAHIU

Spahiu ishte feudal osman që zotëronte feud (timar) me të ardhura vjetore deri në 20.000 akçe. Spahiu e gëzonte timarin me kusht që të shkonte në luftë si kalorës i armatosur me shpenzimet e veta sa herë që e quante të nevojshme pushteti qendror. Kur nuk i përgjigjej thirrjes, spahiu zhvishej nga feudi, kurse po të kryente mirë

shërbimin ushtarak shpërblehej me zmadhimin e feudit. Zotërimi i timarit nuk ishte i përjetshëm, por i biri i spahiu mund të trashëgonte timarin nëse ai përmbushte detyrimet që kishte i ati. Në shek. XV-XVI spahinjtë përbënin pjesën dërrmuese të klasës feudale, si dhe forcën më të rëndësishme ushtarake të Perandorisë Osmane në përgjithësi e po ashtu të trevave shqiptare në veçanti. Me shthurjen e sistemit të timarit u dobësua pozita ekonomike, shoqërore e politike e spahinjve.



SOT NISIN NEGOCIATAT PWR KONTESTIN ME GREQINË

OPTIMIZËM PËR EMRIN



Kryeministri grek, Aleksis Cipras pret në vitin 2018 të ndodh një kthesë më e gjerë në Ballkan, por edhe të ketë ngjarje pozitive lidhur me çështjen e Maqedonisë, nëse, siç tha ai, Shkupi vendos të bëjë hapa pozitiv përpara

Shkup, 10 dhjetor - Ndërmjetësuasi i Kombeve të Bashkuara në bisedimet për çështjen e emrit midis Maqedonisë dhe Greqisë, Metju Nimic, pas pauzës trevjeçare, sot dhe nesër në Bruksel do të ketë takim me përfaqësuesit e të dy vendeve Vasko Naumovski dhe Ademantios Vasilakis. Takimi, siç paralajmëroi Zyra e Nimicit, është pjesë e përpjekjeve të KB-së që t'u ndihmohet të dyja palëve të gjejnë zgjidhje të përbashkët të pranueshme për çështjen e emrit. Raundi i ri vjen në një periudhë të klimës së përmirësuar politike midis Maqedonisë dhe Greqisë, si dhe pritje optimiste nga Shkupi dhe Athina, por edhe nga Uashingtoni për t'i dhënë fund konstitit shumëvjeçar.

Kryeministri i Maqedonisë Zoran Zaev disa herë ka deklaruar se duhet të bëhet një hap përpara dhe se tani ka shanse më të mëdha nga më parë që të gjendet një zgjidhje me Greqinë. Në intervistën për agjencinë greke të lajmeve ANA-MPA, Zaev ka theksuar se duhet të gjendet zgjidhje e cila do të jetë e pranueshme për të

NUK KA ZGJERIM TË EKIPIT NË TAKIMIN ME NIMICIN

Informacioni i transmetuar në më shumë media lidhur me pjesëmarrjen e më shumë personave në procesin e negociatave, jashtë ekipit negociues është jo i saktë, deklaruan për MIA-n nga Ministria e Punëve të Jashtme e Maqedonisë. Siç u theksua paraprakisht nga MPJ, në Bruksel më 12 dhjetor 2017 në negociatat për tejkalimin e dallimeve për emrin do të marrin pjesë negociuesi Vasko Naumovski, ambasador i Republikës së



Maqedonisë në SHBA së bashku me një diplomat të MPJ-së. Format i njëjtë i cili është dakorduar me negociuesin Methju Nimic do të jetë edhe prej palës greke, gjegjësisht negociues plus diplomat. "Qeveria e Republikës së Maqedonisë do t'i informojë mediat, ndërsa me atë edhe opinionin për hapat e mëtejshëm për këtë çështje të rëndësishme dhe të ndjeshme e cila është me interes të lartë shtetëror", theksojnë për MIA-n nga MPJ.

dyja palët. Lidhur me spektrin e lëshimeve që është i gatshëm t'i bëjë, por edhe për këtë nëse pajtohet me ndryshimin e emrit të aeroportit, kryeministri i Maqedonisë thotë se "është e qartë se është më lehtë të ndryshohet emri i një aeroporti se emri i vendit".

Kryeministri grek, Aleksis Cipras pret në vitin 2018 të ndodh një kthesë më e gjerë në Ballkan, por edhe të ketë ngjarje pozitive lidhur me çështjen e Maqedonisë, nëse, siç tha ai, Shkupi vendos të bëjë hapa pozitiv përpara. Paraprakisht, edhe shefi i diplomacisë greke Nikos Koxias, deklaroi se pret që çështja të mbyllet në gjy-

smën e parë të vitit të ardhshëm. Ndërkaq, thotë Koxias, zgjidhja duhet të jetë kompromis për emrin që të hapet rruga e Maqedonisë drejt BE-së dhe organizatave të tjera në të cilat dëshiron të inkadrohet. Optimizëm se kontesti përfundimisht mund të zgjidhet shfaqën edhe zëvendësndihmës sekretari shtetëror amerikan Hojt Ji dhe komisar i evropian Johan Han. Ji konsideron se çështja për emrin deri më tani është në nivel më të lartë dhe më afër gjetjes së zgjidhjes. Han, ndërkaq, deklaroi se pret që në gjysmën e parë të vitit 2018 të gjendet zgjidhje politike me Greqinë për hapjen e ne-

gociatave me Maqedoninë për anëtarësim në BE. Si një shtojcë për këtë, Ji dhe Han, i theksojnë relacionet e përmirësuar politike midis Shkupit dhe Athinës. Vullnet të mirë për zgjidhje tek të dyja palët sheh edhe ndërmjetësuasi Nimic, i cili në një deklaratë për agjencinë e lajmeve - IBNA, shfaqti edhe shpresë se do të tejkalohen edhe të a.q. linjat e kuqe të vendosura nga Athina dhe Shkupi. Mediat greke paralajmërojnë se është e mundur që Nimic në takimin në Bruksel të dalë edhe me propozim të ri për emrin. Raundi i fundit formal i bisedimeve të ndërmjetësuesit të KB-së me përfaqësuesit e të dy vendeve u mbajt në Nju-Jork në nëntor të vitit 2014. Kontesti për emrin midis Athinës dhe Shkupit zgjat që nga pavarësia e Republikës së Maqedonisë në vitin 1991. Për shkak të kundërshtimit të Greqisë, e cila nuk e pranon emrin kushtetues të Maqedonisë, anëtarësimi i Maqedonisë në KB më 8 prill të vitit 1993, ishte bërë nën referencën e përkohshme: Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë. Nën patronatin e KB-së, të dyja vendet filluan bisedime për zgjidhjen e problemit që e ka Greqia me emrin kushtetues të Maqedonisë, të cilat ende po zgjasin.

BORISOV: TË BASHKOHIMI NË ZGJIDHJEN E PROBLEMIT ME EMRIN

Çështjen rreth emrit midis Maqedonisë dhe Greqisë duhet ta zgjidhim. Duhet të bashkohemi dhe t'i ndihmojmë

Komisionit Evropian, t'i ndihmojmë Brukselit të sjellin vendime të drejta dhe jo të vendosin ndonjë ultimatum. Këtë e theksoi kryeministri bullgar, Bojko Borisov në Beograd pas takimit me



presidentin serb, Aleksandar Vučić dhe kryeministrat e Greqisë, Aleksis Cipras dhe të Rumanisë, Mihaj Tudose. "Ne dëshirojmë ta kryejmë detyrën tonë dhe madje atëherë të theksojmë se çfarë propozojmë, ndërsa pjesë e tyre është të vendosin nëse do ta pranojnë ose jo", theksoi Borisov.

Lufta kundër korrupsionit të mos jetë selektive



Shkup, 10 dhjetor - Lideri i Lëvizjes Besa, Bilal Kasami, duke komentuar arrestimin e dhjetëra personave, të cilët ishin pjesë e ngjarjeve të dhunshme të 27 prillit, si përballjen me drejtësinë e strukturave të larta të VMRO-DPMNE-së, thotë për Radion Evropë e Lirë se 5 deputetët e kësaj partie, do ta mbështesin rezervë Qeverinë e Zoran Zaevit. Sipas tij, Qeveria e Zaevit është në rrugë të mbarë për ta pastruar korrupsionin dhe krimin e organizuar brenda institucioneve shtetërore, të instaluar nga qeveria paraprake udhëhequr nga VMRO DPMNE-ja dhe BDI-ja, megjithëse tërheq vërejtjen se lufta kundër korrupsionit duhet të jetë joselektive. "Si Lëvizje Besa, jemi të gatshëm ta përkrahim Qeverinë në ato momente kur do të ketë nevojë për ta pastruar plotësisht me korrupsionin e Qeverisë paraprake. Në këtë drejtim, Lëvizja Besa do të përkrahë çdo aktivitet reformues të Qeverisë. Por, për të pasur mirëbesim, kjo Qeveri, duhet të vazhdojë në këtë frymë që të spastrojë elementet korruptive që tani janë pjesë e saj, si subjekt i koalicionit qeverisës, e që më parë kanë qenë pjesë e Qeverisë me VMRO-DPMNE-në. Vetëm pastrimi i tërësishëm i elementeve të korrupsionit, mund të kthejë besimin e qytetarëve në institucionet e sigurisë, gjyqësorin dhe organet shtetërore në përgjithësi", thotë Kasami. Ai konsideron se ngrirja e proceseve gjyqësore ndaj udhëheqësve të lartë të BDI-së, për të cilët, në bazë të bisedave të përgjuara ka indice se janë pjesë e veprave kriminale, nuk do të ndikojë në stabilitetin e Qeverisë. Përkundrazi, sipas Kasamit, Qeveria do të marrë mbështetje edhe nga deputetët që nuk janë pjesë e koalicionit qeverisës. "Unë besoj se do të krijohen kushtet, po edhe numrat në Parlament, që të mund të pastrohet edhe me këtë pjesë të korrupsionit dhe besoj se deputetët në Parlament do të reflektojnë nëse Qeveria vazhdon që me këtë guxim të merret me problemin serioz, me të cilin është ballafaquar Qeveria në të kaluarën, si në aspektin e korrupsionit, ashtu dhe sa i përket krijimit të rasteve të montuara etj", shprehet Kasami.

BESA DHE ASH FILLOJNË PËRGATITJET PËR KONGRESE ZGJEDHORE

FILLON GARA PARTIAKE

Përderisa Lëvizja BESA ka caktuar datën 24 shkurt të vitit të ardhshëm për mbajtjen e Kongresit zgjedhor, Aleanca për Shqiptarët pritet që garën partiake të fillojë në pranverë, por datën e saktë për mbajtjen e Kongresit pritet ta caktojë Kuvendi Qendror në mbledhjen e radhës më 25 dhjetor

Koha

Fatos RUSHITI

Shkup, 10 dhjetor - Pas garës politike në dy cikle zgjedhore, ato parlamentare vitin e kaluar dhe ato lokale në tetor të këtij viti, Lëvizja BESA dhe Aleanca për Shqiptarët do të nënshtrohen edhe garës së brendshme partiake përmes organizmit të Kongreseve zgjedhore. Përderisa Lëvizja BESA ka caktuar datën 24 shkurt të vitit të ardhshëm për mbajtjen e Kongresit zgjedhor, ASH pritet që garën partiake të fillojë në pranverë, por datën e saktë për mbajtjen e Kongresit pritet ta caktojë Kuvendi Qendror në mbledhjen e radhës më 25 dhjetor. Të dyja këto parti, sipas asaj që thonë funksionarë të latë partiak, nga përcaktimi ideologjik do të vazhdojnë të jenë parti të djathta të qendrës, ndërkaq kongreset zgjedhore do tu shërbejnë për të forcuar radhët me kuadro të rinj, shumica profesionistë të fushave të ndryshme.

"Vetëm se kemi vendosur që Kongresi të mbahet më 24 shkurt, dhe shumë shpejtë do të fillojmë edhe me zgjedhjet partiake nëpër degë dhe nëndegë në të gjitha vendbanimet ku kemi shtrirje në Maqedoni. Sa i përket orientimit ideologjik, tek BESA mbizotëron mendimi që të profilizohemi si parti e qendrës së djathtë, ndërkaq Programi politik do të marrë për bazë vlerat dhe traditat e popullit shqiptarë në Maqedoni me synim ruajtjen dhe kultivimin e tyre në të gjitha institucionet lokale dhe qendrore. BESA do të zhvillojë një garë demokratike dhe do të jap shembull për demokratizimin të partisë për partitë tjera. Gjatë garës partiake, në mënyrë absolute do të jemi të hapur ndaj prurjeve të reja, gjegjësisht ndaj profesionistëve të fushave të ndryshme. BESA me zgjedhjet e lokale duke pasur kandidat edhe kryetarin e saj për Komunën e Tetovës dha shembullin e mirë se lideri duhet marrë përgjegjësi politike duke i nënshtuar garës e



Lëvizja BESA u themelua më 22 nëntor të vitit 2014, ndërsa anëtar të Këshillit Themelues ishin Bilall Kasami, Suad Amzai, Avdush Demiri, Emad Mehmeti, Adnan Azizi, Afrim Gashi, Agim Alili, Amet Zyberi, Hatixhe Maksuti, Hazbi Mamuti, Aziz Idrizi, Bejtulla Demiri, Blerim Sejdiu, Daim Luçi, Behar Sali, Ermira Asani, Fatmir Ejupi, Esmir Selmani dhe tjerë. Kjo parti u bë e njohur me Platformën saj për ridefinimin e shtetit, ndërkaq parti parlamentare u bë në zgjedhjet e fundit - më 11 dhjetor të vitit 2016 duke fituar pesë deputet

jo duke i ikur garës siç ka ndodhë rëndomë në Maqedoni për këto 27 vite demokraci tek partitë shqiptare", theksoi për gazetën KOHA, anëtari i Kryesisë qendrore në Lëvizjen BESA, njëherësh deputet - Fadil Zendeli. Ai nuk deshi të flas prej përpara lidhur me kandidatët e mundshëm për kryetar të BESËS, por tha shkurt se "çdokush që mendon se është i gatshëm të marrë përsipër udhëheqjen e partisë, jo që nuk do të pengohet siç janë penguar të shfaqin ambiciet në partitë tjera, por do të mirëpritet që të bëjnë garën më atraktive dhe më demokratike". Në pyetjen tonë se pse është vonuar tre vite BESA për të mbajtur Kongres të rregullt zgjedhor, Zendeli tha se partia ka dashur të jetë e hapur ndaj njerëzve dhe nga organizimi i zgjedhjeve parlamentare dhe lokale të shihen më qartë potencialet kadrovike në parti. Ndërkohë, tek Aleanca për Shqiptarët - parti kjo që ndërroi emrin para zgjedhjeve lokale, thonë se vetë emri i ri nënkupton se partia gjatë Kongresit do të mirëpres në gjirin e saj komunitetin akademik dhe organizatat joqeveritare të japin kon-

tributin tyre në rritjen e partisë.

"Më 25 dhjetor do të ketë mbledhje Kuvendi Qendror dhe kjo do të jetë e fundit para mbajtjes së Kongresit zgjedhor në pranverë të vitit të ardhshëm. Pjesa e parë do të jetë Analiza e rezultateve të zgjedhjeve lokale, më pas do të vendoset data dhe Komisioni për organizimin e Kongresit. Ajo që ka rëndësi të përmendet është se nga vetë emri Aleancë, obligohemi të ofrojmë komunitetin akademik, organizatat joqeveritare, por dhe njerëz që shquhen për kontribute tek shqiptarët në Maqedoni. Përveç departamenteve kur pritet të përfshihen profesionistët, ne si organe të veçanta kemi Këshillin Mbikëqyrës dhe Këshillin për Politika Strategjike, ku persona me kredibilitet të lartë profesional do të ndihmojnë në profilizimin ideologjik të partisë që sipas të gjitha gjasave do të jetë parti e qendrës me nuance nga e djathta. Kjo, pasi nuk duam të përcaktojmë limite prej përpara në këtë aspekt. Qëllimi është forcimi dhe rritja strukturore partiake. Rezultati në zgjedhjet lokale jep shpresë se ASH do të jetë parti

me një ardhmëri të ndritur e shqiptarëve në Maqedoni. Shembuj se si profesionistët e rinj ishin të suksesshëm në politikë e kemi FRESHI-n në PS dhe KOPIN në PD në Shqipëri dhe qeverinë në hije të PDK-së në Kosovë", thanë për gazetën KOHA nga Departamenti për informim i ASH-së. Lidhur me garën për të parin e partisë, nga ky departament thonë se gara do të jetë e hapur për secilin, përfshirë dhe kryetarin aktual Ziadin Sela. "Presim që përveç Selës, të ketë dhe kandidat tjerë për kryetar të partisë. Gara është e hapur për secilin në parti, nuk ka kufizime kur bëhet fjalë për kreun e partisë", theksuan nga departamenti për informim në ASH. Ndryshe Lëvizja BESA u themelua më 22 nëntor të vitit 2014, ndërsa anëtar të Këshillit Themelues ishin Bilall Kasami, Suad Amzai, Avdush Demiri, Emad Mehmeti, Adnan Azizi, Afrim Gashi, Agim Alili, Amet Zyberi, Hatixhe Maksuti, Hazbi Mamuti, Aziz Idrizi, Bejtulla Demiri, Blerim Sejdiu, Daim Luçi, Behar Sali, Ermira Asani, Fatmir Ejupi, Esmir Selmani dhe tjerë. Kjo parti u bë e njohur me Platformën saj për ridefinimin e shtetit, ndërkaq parti parlamentare u bë në zgjedhjet e fundit - më 11 dhjetor të vitit 2016 duke fituar pesë deputet. Sa i përket pozicionit politik, Lëvizja BESA është parti opozitare, por që përkrah Qeverinë në agjendën e saj reformuese. Ndërkaq Aleanca për Shqiptarët fillimisht u themelua me tjetër emër - si Lëvizja për Reforma në PDSH, në 28 shtator të vitit 2015. Kjo parti ndërroi emrin nga LR-PDSH në Aleanca për Shqiptarët një muaj para zgjedhjeve lokale, ndërsa është parti në pushtet bashkë me LSDM-në dhe BDI-në. Në zgjedhjet parlamentare, ASH ishte në koalicion me RDK-në dhe UNITEITIN duke fituar tre deputetë. Por para zgjedhjeve lokale, ASH prishi koalicionin me këto dy parti, ndërsa në rrethin e dytë zgjedhor të lokaleve ishte në koalicion me Lëvizjen BESA dhe fitoi tre komuna: Gostivarin, Vrapçishtin dhe Bogovinën, ndërsa BESA fitoi në Zhelinë.

XHAFERI E MBYLLI VIZITËN NË UASHINGTON

Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë, Talat Xhaferi në margjinat e Forumit parlamentar të sigurisë në Uashington u takua me Cvetan Cvetanov, koordinator i grupit parlamentar të partisë në pushtet GERB në Kuvendin Popullor të Republikës së Bullgarisë. Nga pres shërbimi parlamentar njoftuan se Xhaferi dhe Cvetanov kanë biseduar për tema me interes të përbashkët, me ç'rast është theksuar se Republika e Bullgarisë, si kryesuese e ardhshme e BE-së, e di rëndësinë e perspektivës evropiane të vendeve të Ballkanit Perëndimor dhe për këtë arsye do të jetë përkrahëse e fuqishme në këtë



drejtim. Temë tjetër të rëndësishme për të cilën biseduan ishin projektet infrastrukturore rajonale. Kryetari i Parlamentit të Maqedonisë është takuar edhe me kryetarin e IRI-t, Daniell Tvinig. Në takim, kryetari Xhaferi ka nënvizuar se puna e IRI-t në Maqedoni është më se e mirëseardhur për shkak se, siç ka theksuar, anketat që i realizojnë ata, përveç asaj që janë neutrale, tregohen edhe si precize, që u konfirmua me rezultatet e zgjedhjeve të paradokohshme. Të dyja palët janë pajtuar se ky bashkëpunim është i dobishëm dhe do të vazhdojë në të ardhmen me intensitet më të madh. Me këto dy takime Xhaferi e përfundoi vizitën e punës në Uashington.

KRONIKË

13 persona të lënduar në aksidentet në Pollog

Tetovë, 10 dhjetor - Katër persona të lënduar, nga të cilët njëri më rëndë si dhe dëmi i shkaktuar material prej 110 mijë denarëve janë pasojat e tre aksidenteve të komunikacionit, të cilat për shkak të mos përshtatjes së shpejtësisë me kushtet në rrugë, kanë ndodhur dje dhe natën e kaluar në rajonin e Tetovës, informon zëdhënësi i sektorit për punë të brendshme në Tetovë Marjan Josifovski. Më keq nga këto aksidente e ka pësuar 75-vjeçarja me iniciale S.F., e cila përdërisa ka qenë duke ecur në këmbë në rrugën e "Lubotenit" në qytet mbrëmë rreth orës 17.25 minuta është goditur nga një veturë e tipit "Reno", me targa të Tetovës e drejtuar nga 22-vjeçari me iniciale R.A gjithashtu nga Tetova. Pas kësaj për pasojë S.F. ka marrë lëndime të rënda dhe me anë të të njëjtës veturë është dërguar në spitalin klinik të Tetovës, nga ku, pas marrjes së ndihmës së parë është transferuar në klinikat e Shkupit. Dy persona të tjerë kanë marrë lëndime trupore, pasi që S.S nga Jançishti ka humbur kontrollin mbi automjetin e tipit "BMV", me targa të Tetovës të cilën vet e ka drejtuar, pas çka vetura, për pasojë, ka dalë nga rruga dhe ka goditur një shtyllë elektrike dhe disa dru zbukurues. Ky aksident ka ndodhur rreth orës 4.15 minuta në fshatin Zhilicë. Pas kësaj, vozitësi dhe bashkudhëtarë i ti, j 20-vjeçari me iniciale D.S., nga fshati Prelubshitë kanë marrë lëndime trupore dhe janë dërguar në spitalin e Tetovës, nga ku pas marrjes së ndihmës janë lëshuar në shtëpi. Dëmi material në këtë aksident komunikacioni vlerësohet që të jetë rreth 100 mijë denarë. Rreth orës 3.45 minuta në rrethorullimin e bulevardit të "Ilindenit" dhe rrugës "Vidoja Smilevski Bato", në Tetovë një veturë e tipit "BMV", me targa të Gostivarit, të cilën e ka drejtuar 28-vjeçari me iniciale D.D., nga Tetova ka humbur kontrollin mbi automjetin dhe, për pasojë, ka dalë nga rruga ku ka goditur një shenjë komunikacioni si dhe disa pllaka begatoni. Pas kësaj, vozitësi i cili ka qenë i vetëm në veturë, për pasojë ka marrë lëndime trupore dhe pas marrjes së ndihmës në spitalin klinik të Tetovës është lëshuar për mjekim shtëpiak, përdërisa dëmi i shkaktuar material vlerësohet të jetë rreth 10 mijë denarë. Policia ka kryer ekspertizë në të tre vendet ku kanë ndodhur këto aksidente dhe sipas të dhënave fillestare që dalin nga ekspertiza e kryer në vendngjarje si shkak për këto aksidente është mos përshtatja e shpejtësisë me kushtet në rrugë. Në një aksident komunikacioni që ka ndodhur të shtunën, rreth orës 17 e 30, minuta në rrugën rajonale Gostivar-Kërçovë, në të cilin janë përfshirë tre automjete janë lënduar nëntë persona, prej të cilëve njëri ka marrë lëndime më serioze, kumtoi zëdhënësi i SPB Tetovës, Marjan Josifovski. Tre automjetet që kanë qenë pjesë e aksidentit kanë qenë me targa të Gostivarit, edhe atë, një veturë "Golf" e drejtuar nga F.O.(34), "Lupo" e drejtuar nga Z.M.(58) dhe "Kia" e drejtuar nga T.A. (59), të gjithë nga Gostivari. Në këtë aksident lëndime të rënda trupore ka marrë Z.M., vozitësi i "Lupo", ndërsa vozitësi i "Kia" së bashku me shtatë udhëtarë tjerë nga tre veturat kanë marrë lëndime më të lehta. Të gjithë të lënduarit janë dërguar në Spitalin e përgjithshëm në Gostivar, ku pas ndihmës mjekësore janë lëshuar në mjekim shtëpiak. Dëmi i përgjithshëm material në këtë aksident vlerësohet mbi 300.000 denarë. Policia ka kryer ekspertizë dhe sipas informatave fillestare shkakuar i aksidentit është mos mbajtja e distancës ndërmjet automjeteve. (U.H)

RRITJA E TRANSPARENCËS NË GJYQËSOR EDHE PËRMES RRJETEVE SOCIALE

GJYKATAT TË HAPEN



Gjykatësit dhe prokurorët, të cilën morën pjesën në diskutimet për transparencën në gjyqësor, nënvizuan se nga elaborimi i legjislacionit ndërkombëtar dhe atij vendor - doemos paraqitet nevoja e përforcimit të kapaciteteve të shërbimeve për informim brenda gjykatave dhe vendosjen e "e-gjyqësorit"

Koha

Omer XHAFERI

Shkup, 10 dhjetor - Rritja e transparencës në punën e gjykatave në raport me mediat dhe opinionin në përgjithësi, duhet të bëhet edhe nëpërmjet shfrytëzimit të rrjeteve sociale bashkëkohore. Kjo ide dhe shumë propozime tjera për transparencën në sistemi gjyqësor u përmenden në debatin e fundit të cilën Shoqata e Gjykatësve të Maqedonisë e organizoi me temë "Transparenca e gjykatave", ku mes tjerash u tha se respektimi i këtij parimi paraqet kontribut të rëndësishëm në realizimin e sigurisë juridike. Rimodelimi i sektorëve për marrëdhënie me publikun në kuadër të gjykatave, siç u tha në këtë debat, duhet të bëhet paralelisht me zhvillimin digjital të shoqërisë. Mungesa e transparencës nga gjykatat e Maqedonisë është theksuar edhe në Strategjinë e fundit të Qeverisë për reforma në sistemin juridik, gjegjësisht vërejtjet e tija lidhur me këtë çështje i ka përmendur edhe i dërguesi special i Komisioni Evropian, Rajhard Pribe.

Gjykatësit dhe prokurorët të cilën morën pjesën në diskutimet për transparencën në gjyqësor, nënvizuan se nga elaborimi i legjislacionit ndërkombëtar dhe atij vendas kur flasim opinionin dhe transparencën doemos e paraqet nevojën e përforcimit të kapaciteteve të shërbimeve për informim brenda gjykatave dhe vendosjen e e-gjyqësorit. Gjykatësi Shpend Devaja, i cili njëkohësisht është pjesë e Gjykatës së Lartë të Maqedonisë, me këtë rast theksoi se mediat luajnë një rol të rëndësishëm për transparencën në sistemin gjyqësor, gjegjësisht sipas tij kjo paraqet një prej shtyllave të proceseve demokratike. "Transparenca është e me rëndësishme të posaçëm për zhvillimin



SHPEND DEVAJA

Fatkeqësisht në opinion ekziston vlerësimi se gjykatësit nuk janë mjaftë transparent. Ne si gjykatës duhet të fillojmë ta ndryshojmë këtë perceptim dhe të fillojmë të ndërtojmë ura bashkëpunimi në mes mediave dhe gjykatësve, respektivisht me zhvillimin e këtyre raporteve do të ndryshohet edhe mendimi për gjykatësit

e proceseve demokratike, me çka në këto procese gjykatësit nuk duhet të jenë imun ndaj kritikave konstruktive. Atëherë kur këto kritika ti adresohen një gjykatësit, ai duhet t'ju qaset me një kujdes të posaçëm. Fatkeqësisht në opinion ekziston vlerësimi se gjykatësit nuk janë mjaftë transparent. Ne si gjykatës duhet të fillojmë ta ndryshojmë këtë perceptim dhe të fillojmë të ndërtojmë ura bashkëpunimi në mes mediave dhe gjykatësve, respektivisht me zhvillimin e këtyre raporteve do të ndryshohet edhe mendimi për gjykatësit", tha gjykatësi, Devaja. Mos azhurnimi në kohë i vendimeve gjyqësore dhe informacioneve, sipas tij çon deri në atë shkallë sa që gazetarët në mungesë të të dhënave angazhohen në gjetjen e mënyrave alternative për marrjen e informacionit.

Duke folur për rrjetet sociale, Devaja tha se ato janë mediat tejet të fuqishme, respektivisht gjatë elaborimit të situatës aktuale, ai shtoi se në planë ndërkombëtar ekzistojnë dy qasje të ndryshe. Me këtë rast ai bëri krahasim mes gjykatësve evropian dhe atyre amerikan, me çka këta ta fundit ë masë të madhe i përdorin këto medime (rrjetet sociale), gjegjësisht në disa raste ato japin edhe vlerësime të veta për ndonjë çështje të caktuar, por çdo herë në emër të vetë dhe asnjëherë në emër të gjykatës (institucionit). Pjesë e debatit për "Transparencën në gjyqësor" për të cilën më hollësisht raportuan nga portali "Akademik", ishte edhe prokurorja speciale Lile Stefanova, e cila theksoi se gjykatësit dhe prokurorët duhet ti rregullojnë radhët e tyre dhe ta ndryshojnë mendimin e opinionit për atë se këta profesione janë të korruptuara. Transparenca më e madhe sipas prokurorës së Prokurorisë Speciale Publike, Stefanova, duhet të ekzistojë edhe gjatë përzgjedhjes së gjykatësve apo prokurorëve, si dhe në të gjitha proceset tjera gjyqësore. "Kuptohet se edhe unë jam për transparencë të gjykatave dhe prokurorive. Ne duhet të jemi transparent gjatë shpalljes së vendimeve tona. Kjo doemos duhet të bëhet, por jo edhe atëherë kur mundet ta dëmtojë një proces të caktuar", tha prokurorja speciale, Lile Stefanova. Ndryshe, në këtë debati i cili u mbështet edhe nga ana e ambasadës së SHBA-ve në Shkup, u potencuan se mediat dhe opinionin duhet të jenë të informuar për procedurat, gjegjësisht gjatë këtyre njoftimeve nuk duhet të anashkalohej e drejta e kritikës, mirëpo jo këto raporte të bëhen në mënyrë sensacionale e cila do ta varroste besueshmërinë e qytetarëve ndaj gjyqësorit.

KRONIKË

Arrestohet gjahtari që vrau gjahtarin

Sektori për Punë të Brendshme në Strumicë nga Prokuroria Publike Themelore Strumicë, shtroi padi penale kundër Z.I. (38) nga Strumica, për shkak të ekzistimit të dyshimit se ka kryer vepër penale "vepra të rënda kundër sigurisë së përgjithshme", ndërsa gjykatësi i procedurës paraprake i Gjykatës Themelore të Strumicës i përcaktoi arrest në kohëzgjatje prej 30 ditësh. MPB kumtoi se pardje rreth orës 13,50 në vendin e quajtur "Medev rid", atari i fshatit Belotinë, në afërsi të digës Vodoça, i denoncuari së bashku me shtatë persona të tjerë ka qenë në gjah. Në një moment ka gjuajtur një fishek me pushkë pronë e një personi nga Belotina dhe ka qëlluar personin Zh.I. nga fshati Riç, i cili në atë moment ka lëvizur nëpër pyllin e dendur në largësi prej rreth 30 metrash. Zh.I. është plagosur në kokë me ç'rast ka filluar t'i rrjedh shumë gjak dhe e ka humbur vetëdijen. I denoncuari me qëllim që ta fsheh ngjarjen, i ka njoftuar personat e tjerë të cilët në ndërkohë kanë ardhur në ndihmë, se Zh.I. nga pakujdesia është vetëplagosur, më pas e ka marrë pushkën të cilën e ka përdorur personi i ndjerë dhe ka dërguar në një vend tjetër në largësi prej 50 metrash. Pasi i lënduari nga personat e tjerë të cilët kanë qenë në gjah është hipur në traktor me qëllim që më shpejtë t'i ofrohet ndihmë mjekësore, i denoncuari e ka marrë pushkën me të cilën ka qenë në gjah, është larguar drejt digës Vodoça dhe fishekun e përdorur e ka nxjerrë nga pushka dhe e ka hedhur në ujë, me ç'rast është nisur drejt Belotines duke ia kthyer pushkën personit prej të cilit e ka marrë së bashku me edhe katër fishekë të papërdorur. I lënduari më pas me automjetin e ndihmës së shpejtë është transferuar në ISHP Spitali i Përgjithshëm Strumicë, ku edhe krahas ndihmës së ofruar mjekësore u është nënshtruar plagëve. Me urdhrin e prokurorit publik është bërë obduksion ndaj trupit të të vdekurit. I denoncuari është privuar nga liria dhe po mbahet në Stacionin policor në Strumicë.

Një i plagosur nga të shtënat në Ohër

Një person është plagosur në të shtënat të cilat sot pasdite ndodhën në Ohër, në afërsi të rrethrotullimit në bulevardin "Turistička" pranë rrugës "Bistrica". Policia e konfirmoi incidentin pa zbuluar më shumë detaje për rastin, përveç se i lënduari ndodhet jashtë rrezikut për jetë. Ekipi i teknikës së krimit është duke bërë ekspertizë në vendin e ngjarjes, si dhe masa të tjera operative për zbardhjen e rastit.

Përfshihet në flakë një automjet në Shkup

Në Qendrën Tregtare "Siti Moll" në Shkup, në parkingun e katit më të lartë, tani për tani për shkaqe të panjohura ka shpërthyer zjarr në automjetin "Mercedes" me targa të Tetovës, pronësi e M.A. (31) nga Tetova. Siç informon policia, incidenti është denoncuar djë në orën 15.55. Zjarri është shuar nga ana e personave të sigurimit të Qendrës Tregtare.

BURSAT E MASH-it

SHQIPTARËT, TALENTË TË PA AKREDITUAR

Ashtu sikurse edhe ishte paralajmëruar në KOHA, bursat e nxënësve të talentuar të të dyja kategoritë nuk kanë mundur të shmangin as këtë vit problematikën e jo harmonisë nacionale. Te bursat për nxënësit e talentuar sportiv, në listën e 81 ftuesve, vetëm 3 janë nxënës shqiptarë. Te kategoria e nxënësve përgjithësisht të talentuar, në mesin e 65 fituesve vetëm 6 janë shqiptarë

Koha

Laura PAPANIKU

Shkup, 10 dhjetor - Jo të gjithë ata të cilët kanë aplikuar dhe jo të gjitha kategoritë e bursave do të ndahen këtë vit në lartësinë e paraparë me konkurset përkatëse të Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës (MASH). Në raste të caktuara ka pasur tejkalim të numrit të paraparë të bursave, sikurse është kategoria për nxënësit e talentuar të shkollave të mesme, ashtu siç ka kategori të tjera, ku numri i nxënësve që kanë aplikuar është poshtë numrit të bursave që MASH kishte vënë në dispozicion. Por, marrë në total, për gjashtë kategoritë e bursave për vitin shkollor 2017/2018, numri i aplikimeve është më i madh se numri i planifikuar, ndërsa është goxha më i ulët numri i bursave të fituara.

Në bazë të listave që MASH ka publikuar pasditen e së enjtes, për 745 bursat në dispozicion të nxënësve të shkollave, në të gjitha format kishin aplikuar 948 nxënës. Bazuar në kriteret e shënuara paraprakisht nëpër konkurse, për të gjitha kategoritë veç e veç, komisionet përkatëse u kanë dhënë dritën e gjelbër vetëm 621 nxënësve. Të gjithë do të përfitojnë

përafërsisht nga 3 mijë denarë për nëntë muaj, aq sa zgjat një vit shkollor. Numri më i madh i bursave të ndara janë te kategoria sociale, ku këtë vit shkollor janë ndarë fiks 400 bursa, pra po aq sa ishin caktuar me konkurs. Por bursat e nxënësve të talentuar, të të dyja kategoritë, duket se nuk kanë mundur të shmangin as këtë vit problematikën e jo harmonisë nacionale. Raporti më i thellë është te bursat për nxënësit e talentuar sportiv, ku në listën e 81 ftuesve vetëm 3 janë nxënës shqiptarë. Te kjo kategori është publikuar edhe një listë tjetër me emrat e 67 nxënësve, të cilët nuk kanë plotësuar kushtet e kërkuara me konkurs dhe ku 18 prej tyre janë shqiptarë. Një numër i konsiderueshëm i nxënësve të kësaj liste nuk janë fitues, ose sepse çmimet nuk janë në nivelin e kërkuar të konkursit, ose sepse çmimet e tyre janë më të vjetra se sa një vit shkollor apo sepse sukcesi i notave është më i ulët se katër. Kështu, edhe pse për 150 bursat e kësaj kategorie kishin aplikuar 148 nxënës, 81 gjenden në listën e fituesve, kurse 67 në listën e jo fituesve. Ndërkaq te kategoria e bursave për nxënësit përgjithësisht të talentuar të shkollave të mesme publike dhe private, situata është shumë më dinamike. E para, kanë konkurruar pesëfish më tepër nxënës se sa numri i paraparë me Konkurs, pra për 50 bursat në dispozicion, kanë aplikuar 264 nxënës, ndërsa janë lejuar 65 të tillë, që do të thotë se është kapërcyer limiti i paraparë. Bazuar në emrat dhe mbiemrat e nxënësve, te fituesit e këtyre bursave, rezultoni se 56 janë maqedonas, 6 shqiptarë dhe 3 të tjerë. Këtu gjenden edhe nxënës që kanë më pak pikë se disa të tjerë që enden në listën e 32 nxënësve,

që plotësojnë kushtet e kërkuara me konkurs, por që nuk do të jenë fitues pasi është vendosur vija e kuqe te nxënësi i 65-të i një listë më lartë. Lista e tretë e bursave të kësaj kategorie përbëhet nga 167 nxënës, të cilët nuk janë fitues, pasi nuk i plotësojnë kriteret e shënuara në konkurs. Pikërisht te kjo listë, gjendet dhe numri më i madh i nxënësve shqiptarë, të cilët përbëjnë mbi 22 për qind të listës. Konkretisht në mesin e 167 emrave jo fituese, 37 janë të nxënësve shqiptarë shqiptarë, pjesa me e madhe e të cilëve nuk kanë fituar me arsyetimin se diplomat që vërtetojë pjesëmarrjen dhe fitimi e çmimeve nëpër gara janë nga ana e shoqatave të pa akredituara. Për pasojë, ata kanë humbur shansin të gjenden në dy listat paraprake, pra ose të listës së parë me emrat e nxënësve fitues të konkursit për bursa nxënësve të talentuar të shkollave të mesme dhe private, ose të atyre që edhe pse kanë plotësuar kushtet e kërkuar me konkurs nuk janë fitues pasi gjenden poshtë limitit të lejuar. Në dy kategoritë e bursave për nxënës të talentuar, përgjithësisht dhe specifikisht të talentuar sportiv për vitin shkollor 2017/2018 do të ndahen 65, respektivisht 81 bursa. Prej tyre, nxënësit shqiptarë do të marrin vetëm 9 bursa, edhe atë 6 për kategorinë e parë dhe 3 për kategorinë e dytë. Te kategoria e bursave sociale gjenden emrat e 84 nxënësve shqiptarë nga gjithsej 400 fitues, kurse te bursat për nxënës me nevoja të veçanta, 11 nxënës shqiptarë, 36 maqedonas dhe 3 të tjerë. Nga 80 bursat për nxënësit pa prindër, janë ndarë vetëm 23 aq sa ishte edhe numri i aplikimeve, ndërsa për 15 bursat e nxënësve të turizmit dhe hotelierisë fitues janë vetëm dy nxënës.



Te kategori e bursave sociale gjenden emrat e 84 nxënësve shqiptarë nga gjithsej 400 fitues, kurse te bursat për nxënës me nevoja të veçanta, 11 nxënës shqiptarë, 36 maqedonas dhe 3 të tjerë. Nga 80 bursat për nxënësit pa prindër, janë ndarë vetëm 23 aq sa ishte edhe numri i aplikimeve, ndërsa për 15 bursat e nxënësve të turizmit dhe hotelierisë fitues janë vetëm dy nxënës

LAJME
SHKURT**Nuk do të ketë
kartela të reja elektronike
shëndetësore**

Shkup, 10 dhjetor - Nuk do të shtypen kartela të reja elektronike, ndërsa mjekëve të cilëve deri në fund të vitit u skadon afati i kartelës që të mund të futen në sistemin shëndetësor duhet të furnizohen me certifikatë digjitale. Problem me kartelat elektronike ka tashmë tre vite, por këtë vit problemi është më serioz pasi skadon afati i kartelave të më shumë se 500.000 qytetarëve. Qeveria e kaluar nuk nënshkroi në kohë tender për përzgjedhje të firmës e cila do të shtyp kartelat e reja, ndërsa ish ministri Arben Taravari, i cili tani është kryetar i Gostivarit, gjatë verës thye se do ta ndryshojë sistemin me kartela, përkatësisht kartela elektronike dhe letërnjoftimi do të jenë një, por se kjo do të ndodh pas dy tre vitesh. Ministria e shëndetësisë tani thotë se kanë formuar grup punuese me përfaqësues të ministrisë, Fondit për sigurim shëndetësor, drejtoria për shëndet elektronik dhe fakultetit të shkencave të informatikës dhe kompjuterist inxhinierie, dhe se kjo grup ka përpunuar propozim për të siguruar vazhdimin e shërbimeve elektronike në sistemin shëndetësor.

**Deri 50.000 qytetarë në
ditë pinë antibiotikë**

Shkup, 10 dhjetor - Nga 40 deri 50 mijë qytetarë të Maqedonisë në ditë pinë antibiotikë. Shqetëson fakti se pjesën më të madhe të ilaçeve e pinë pa ia caktuar mjeku për ftohje të thjeshtë. Ekspertët paralajmërojnë se pirja e tepruar e antibiotikëve i bën njerëzit imun dhe ato ilaçe nuk do të kenë efekt kur me të vërtetë ata do të kenë nevojë. Vitin e kaluar 70 qytetarë u bënë rezistent me së shpeshti nga bakteret esherihija koli dhe stafilkoka. Sipas të dhënave të institucioneve kompetente shëndetësore për çdo ditë terapi me antibiotikë shfrytëzojnë 40 deri 50 mijë qytetarë. Edhe Organizata Botërore e Shëndetësisë kohën e fundit paralajmëron se bota po mbetet pa antibiotikë efikas për shkak të përdorimit të tyre pa nevojë, ndërsa nga infeksionet jorezistente në vit vdesin 250.000 qytetarë.

**Gati për borën, 30 tonë kripë
hidhen në rrugët e Shkupit**

Shkup, 10 dhjetor - Autoritetet e qytetit janë të gatshme për mirëmbajtjen e rrugëve në rajonin e Shkupit në kushte dimri. Pas të reshurave të para të borës në këtë sezon, ekipet e shërbimit dimëror të Qytetit të Shkupit kanë intervenuar në mënyrë parandaluese në shumë rrugë dhe pika kritike dhe kanë hedhur 30 tonë kripë. Shërbimi dimëror i Qytetit të Shkupit për momentin ka rezerva të kripës në depot e Ndërmarrjes Publike "Rrugë dhe Rrugica" prej rreth 1.300 tonë dhe në vijim është procedura e tenderit për furnizimin edhe të 3.000 tonë kripë. Krahas kripës dhe asfaltit të ftohtë, shërbimi dimëror do ta përdorë mekanizmin e Ndërmarrjes Publike "Rrugë dhe Rrugica" të përbërë prej 16 automjeteve dhe makinave të ndryshme, ndërsa në dispozicion është edhe mekanizmi i ndërmarrjeve të tjera publike të qytetit. Në mënyrë shtesë është siguruar edhe mbështetja teknike e kompanisë e cila shërbimeve dimërore gjatë sezonit ia vë në dispozicion 15 automjete speciale - kamionë.

RËNIE E MADHE E INVESTIMEVE TË HUAJA**140 MILIONË
EURO MË PAK**

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 10 dhjetor - Prej fillimit të vitit deri në muajin shtator të këtij viti, janë shënuar investime të huaja në vlerë prej vetëm 45 milionë euro. Kjo paraqet një rënie të madhe prej 140 milionë euro në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur në Maqedoni janë investuar afër 185 milionë euro. Kjo, me fjalë të tjera, tregon se janë shënuar afër 74 për qind më pak investime në të periudhën janar-shtator të 2017, në raport me periudhën janar-shtator 2016.

Vlerësohet se kriza politike ngadalëson si planet investuese të kompanive të huaja ashtu edhe atyre vendore për të zgjeruar kapacitetet, të marrin kredi të reja ose të zgjerojnë kapacitetet e tyre në prodhim, por edhe në shërbim. Sipas ekonomistëve, kriza e stërzgatur politike në dy vitet e kaluara, ka marrë haraçin e saj dhe është pasqyruar negativisht në vendimet e investitorëve të huaj, që të investojnë në një shtet me klimë jostabile politike.

Afaristët thonë se kushti kryesor i investimeve më të mëdha të huaja vendore mbetet anëtarësimi i Maqedonisë në NATO, si dhe stabiliteti afatgjatë politik dhe ekonomik, së bashku me hapjen e bisedimeve të shtetit për t'u anëtarësuar në Bashkimin Evropian. Analistët ekonomik thonë se nuk duhet harruar se

Maqedonia si shtet ka dobësinë që është shtet kontinental që nuk ka dalje në det, ka një treg të vogël, ndërsa turbulencat politike paraqesin problem shtesë. Sipas kryetarit të Organizatës së punëdhënësve të Maqedonisë, Angel Dimitrov, kriza politike patjetër se ndikon në planet investuese të investitorëve të huaj, por sipas tij nuk duhet harruar se të gjitha shtetet në rajon bëjnë një garë të fuqishme për të tërhequr sa më shumë kapital të huaj që do të hapë vende të reja pune. "Shtetet e rajonit në përgjithësi shquhen me jostabilitet politik, por megjithatë ekzistojnë edhe faktorë të tjerë që nuk duhet të anashkalohej. Edhe fqinjët tanë janë në garë të madhe se kush do të ofrojë kushte më të mira për investime për investitorët e huaj.

Nga Maqedonia, rezultate më të dobëta, me 268 milionë euro në vitin e kaluar, shënon vetëm Bosnje e Hercegovina dhe Kosova që në vitin 2016 ka realizuar investime të huaja në vlerë prej 215 milionë euro. Në Serbi në vitin e kaluar janë investuar afër dy miliardë euro, në Slloveni afër 1 miliardë euro dhe në Kroaci janë investuar 385 milionë euro

Nga ana tjetër, kemi edhe më shumë tregues që nuk varen nga ndihmat për investitorët e huaj, siç janë kuadri i arsimuar dhe i trajnuar, madhësia e tregut, infrastruktura dhe më shumë tregues të tjerë që shpesh nuk merren parasysh gjatë shqyrtimit të kësaj çështje", thekson Dimitrov.

Në ndërkohë pritet që në periudhën e ardhshme të rriten dukshëm vëllimi i investimeve të huaja në Maqedoni. sidomos pas paralajmërimeve për zgjidhjen e kontestit të emrit, fillimit të negociatave për anëtarësim me Bashkimin Evropian Me interesimin në rritje të

Prej fillimit të vitit deri në muajin shtator të këtij viti janë shënuar investime të huaja në vlerë prej vetëm 45 milionë euro. Kjo paraqet një rënie të madhe prej 140 milionë euro në raport me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, kur janë investuar afër 185 milionë euro

SHBA-ve dhe Brukselit për të stabilizuar më tej rajonin, pritet të hapet edhe rruga për zhvillim më të madh ekonomik. Bile SHBA-të parashikojnë ndër të tjerash edhe vendosjen e një pranije të përhershme ushtarake në Evropën juglindore. Sipas Zërit të Amerikës, është paralajmëruar edhe rivendosja e reputacionit të Shteteve të Bashkuara si ndërmjetës i ndershëm që duhet të nxihet për përpjekjet për të përgatitur Athinën dhe Shkupin që të bëhen aleatë dhe t'i bashkohen BE-së, si dhe për të çuar bisedimet ndërmjet Beogradit e Prishtinës drejt përmbylljes. Nga ana tjetër, para tre javësh nga ekzekutivi i ri paralajmëruan se me përfundimin e krizës politike do të rritet numri i investitorëve të huaj. Kryeministri Zoran Zaev në konferencën e përbashkët me komisararin Johannes Han, paralajmëroi se me 19 investitorë të huaj po nënshkruhen apo janë para nënshkrimit të marrëveshjeve për investime të reja.

Ndryshe, investimet e huaja në Maqedoni në vitin e kaluar arritën në 358.4 milionë euro që është për tre herë më pak se niveli i tyre në Shqipëri, ku në vitin e kaluar u investuan gati një miliardë euro. Nga Maqedonia, rezultate më të dobëta, me 268 milionë euro në vitin e kaluar, shënon vetëm Bosnje e Hercegovina dhe Kosova që në vitin 2016 ka realizuar investime të huaja në vlerë prej 215 milionë euro. Në Serbi në vitin e kaluar janë investuar afër dy miliardë euro, në Slloveni afër 1 miliardë euro dhe në Kroaci janë investuar 385 milionë euro.

Në të kaluarën në Tetovë ka pasur shumë parqe, të cilët janë shfrytëzuar nga qytetarët, kurse tani ka mbetur vetëm ai pranë Xhamisë së larme, ndërsa së fundi është rregulluar edhe parku afër stacionit të autobusëve

TETOVA PA VENDE TË GJELBRA MË SHUMË BETON SE SA PARQE



sur shumë parqe, të cilët janë shfrytëzuar nga qytetarët, kurse tani ka mbetur vetëm ai pranë Xhamisë së larme, ndërsa së fundi është rregulluar edhe parku afër stacionit të autobusëve.

Qyteti i Tetovës ndër vite po i humb edhe ato pak hapësira të gjelbra që i ka. Pjesa dërmuese e hapësirave të lira, të cilët kanë qenë me gjelbërim janë uzurpuar dhe në ato vende janë bërë ndërtime. Nga NPK-ja, krahas kësaj, thonë se për më shumë pastërti vendosin edhe shporta, por ato dëmtohen.

“Shpesh herë kalimtarë të rastit dëmtojnë shportat dhe të njëjtat mund të them se janë në gjendje të mjerueshme. Prandaj, në këtë drejtim duhet edhe një vetëdije më e lartë e qytetarëve që të mos i dëmtojnë ato, sepse bashkërisht mund të kontribuojmë për një ambient më të pastër në qytetin e Tetovës”, thonë nga kjo ndërmarrje.

Nga Policia e Tetovës kanë apeluar që qytetarët të kenë kujdes dhe ta mbrojnë ambientin ku jetojnë, sepse në të kundërtën do të përballen me dënime.

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 10 dhjetor - Tetova ngel pa hapësira të gjelbër viteve të fundit. Të njëjtat shkatërrohen në mënyrë të pamëshirshme. Një nga parqet më të gjata përgjatë rrugës “Boris Kidriç”, duke filluar nga Qendra për Kulturë deri te Qendra Sportive, tashmë viteve të fundit është përfshirë nga ndërtimet dhe zaptimet e tavernave. Një pjesë tashmë është rregulluar si parking, ndërsa përgjatë rrugës janë vendosur edhe mburoja prej metali për ndërtimet që zhvillohen. Qytetarët theksojnë se me ndërtimet e reja në qytet dëmtohen hapësirat e gjelbra, të cilët përvetësohen nga investitorët,

duke mos lënë asnjë hapësirë të gjelbër apo parqe.

“Viteve të fundit shohim vetëm beton gjithandej. Parqet dhe gjelbërimi, edhe ato pak që ishin janë duke u zhdukur tërësisht. Ka shumë pak në qytet vende me gjelbërim, prandaj edhe kemi shumë ndotje dhe papastërti. Duhet që më shumë të punohet që të kemi më shumë hapësira të gjelbër, sepse ajo i jep pasqyrë më të mirë qytetit”, thotë Arjani, një qytetar i Tetovës.

Në Tetovë dëmtime të këtilla ka gjithandej, sidomos në pjesët

ku janë ndërtuar ndërtesa të mëdha. Kjo, edhe viteve të kaluara, sipas ekspertëve ishte një ndër arsyt kryesore të ndotjes për shkak të mos qarkullimit të ajrit. Nga Komuna e Tetovës thonë se hapësirat e gjelbra do t’u kthehen qytetarëve.

“NPK Tetova - Tetovë, do të del në terren, do të inspektojë dëmtimet dhe në bashkëpunim me investitorët të cilët ndërtojnë në atë pjesë, do të kthehen hapësirat e gjelbra. Në Tetovë kemi diku rreth 41.123 metra katrorë sipërfaqe të gjelbra publike, por po ballafaqohemi me një problem, ne të

gjithëjemi të vetëdijshëm se uzurpohen në mënyrë të paskrupullit hapësirat publike, mirëpo tendenca jonë edhe si komunë, edhe si ndërmarrje, është që ata sipërfaqe t’i zhbllokojmë dhe t’i kthejmë tek qytetarët”, thonë nga pushteti lokal në Tetovë.

Në qytetin e Tetovës, i cili tashmë është shndërruar në asfalt, nuk respektohet as në minimum hapësira e gjelbra, e cila, sipas standardeve evropiane, nevojitet që për kokë banori të ketë 16 metër kub hapësirë të gjelbër.

Në të kaluarën në Tetovë ka pa-

Struga po e humb identitetin

Strugë, 10 dhjetor - Shkatërrimi dhe humbja e identitetit të shumë shtëpive dhe lagjeve karakteristike në qytetin e Strugës, po shihet me shqetësim nga një pjesë e qytetarëve që janë të interesuar për vazhdimësinë ruajtjen e kësaj trashëgimie. Për ta, kjo që po ndodh me qytetin e Strugës ku lagje të tëra apo objekte të caktuara që kanë pasur një vlerë kulturore nga pikëpamja ur-

banistike, po u lënë vendin objekteve të reja, do i sjelli një dëm të pakthyesëm qytetit si nga pikëpamja kulturore ashtu edhe nga pikëpamje turistike.

Ndërkohë, edhe Shoqatat për mbrojtjen e ambientit në Strugë si “En Hallon” dhe “Eko-Vel” në shumë raste kanë përsëritur qëndrimin se dita ditës në qytetin e tyre po ngushtohen hapësirat e gjelbra dhe po

merr hapësirë ndërtimi. Sipas tyre, kjo tendencë ka marrë një hov të madh gjatë këtyre viteve të fundit dhe po lulëzon dita ditës dhe po prek të gjithë hapësirat e gjelbra në komunë dhe nuk di të ndalur. Të gjitha këto akte të drejtuara kundër natyrës po bëhen edhe me miratimin e heshtur të institucioneve vendore dhe qendrore, të cilat me veprimet e tyre jo që nuk po e



ndalojnë, por po e stimulojnë këtë dukuri, akuzojnë ekologjistët struganë. Ata porosisin që tokën duhet lënë gjeneratave të ardhshme, ash-

tu siç e pranuan nga paraardhësit tanë. Toka është nëna e jetës, japin mesazhin ekologjistët struganë. (strugalajm.com)

Publicitet

Në bazë të nenit 37-e dhe nenit 37-i të Ligjit për ndërmarrjet publike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 38/96, 6/2002, 40/2003, 49/2006, 22/2007, 83/2009, 97/2010, 97/2010, 6/2012, 119/2013, 41/2014, 138/2014, 25/2015, 61/2015 dhe 39/2016), nenit 3 të Rregullores për formën dhe përmbajtjen e shpalljes publike për punësim dhe shpalljes interne për avancim, mënyrën e parashtimit të fletëparaqitjes për punësim dhe avancim, mënyrën për realizim të përzgjedhjes për punësim dhe për avancim, si dhe mënyrën për dhënie të pikëve për ofertesit e shërbimeve publike nr. 02-624/1 të datës 06.12.2017, U. D Drejtori i NPPK “Usluga” Berovë publikon:

Shpallje publike nr. 1/2017

Për punësim të 1 (një) ofruesi të shërbimeve publike për kohë të pacaktuar për vendin e punës në vijim

1. KDR 0305 A03 047- Udheheqës së departamentit për mirëmbajtje mekanike të stacionit të filtrimit (pompa, stacione për ujë të pijshëm dhe rezervuare) – 1 (një) realizues

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë shtetas i RM
- Në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase
- Të jetë i moshës së rritur
- Të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës
- Me vendim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës

Kushtet e posaçme:

- Të ketë të fituara së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1 të Makinierisë, elektromakinierisë ose elektroteknikës,
- Së paku dy vjet përvojë pune në profesion,
- Njohje aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë,
- Njohje të një prej tre gjuhëve të përdorura më së shpeshti në Bashkimin evropian.

Orari i kohës së punës:

- Lloji i punësimit: kohë e pacaktuar
- Ditët e punës: e hënë – e premte
- Orët e punës në javë: 40 orë
- Orari i punës: 07:00 deri më 15:00
- Shuma në të holla e pagesës bazë: 18.130,00 denarë.

Vërejtje: Me kandidatët realizohet intervistë.

Kandidati i cili ka futur të dhëna jo të vërteta në fletëparaqitje diskualifikohet nga procedura e mëtutjeshme.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Shpallja publike zgjatë 15 (pesëmbëdhjetë) ditë dhe fillon të rrjedhë nga dita e publikimit.

Zgjedhja do të realizohet në afat prej 10 (dhjetë) ditëve.

Formulari i fletëparaqitjes për punësim merret në Arkivin e NPPK “Usluga” Berovë.

Fletëparaqitja së bashku me dokumentet e nevojshme të parashtrohet deri në NPPK “Usluga” Berovë rr “Marshall Tito” pn në Berovë.

NPPK “Usluga” Berovë
U. D Drejtor
Sllave Llukaroski

07.12.2017.

ST nr. 60/16

SHPALLJE PUBLIKE nr. 46/2

Për shitje elektronike të pronës së borxhliut të falimentuar EMO Ohër SHA f. Kosel në falimentim për herë të DYTË

Lëndë e Shpalljes publike është shitja e pronës së patundshme përmes e-ankandit, ndërsa në pajtim me nenin 98 dhe 99 të LF dhe Rregulloren për mënyrën e realizimit të procedurës për shitje elektronike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 47/2014) në pako edhe atë:

OBJEKTET NË SARAJ SHKUP

Ndërtesa nr. 1 me sipërfaqe prej **1988 m2** në përdhese, qëllimi HA, e evidentuar në PK 10337 në Listën pronësore 10397 KK SARAJ Shkup.

Ndërtesa nr. 1 me sipërfaqe prej **od 6 m2** në përdhese, qëllimi NP, e evidentuar në PK 10337 në Listën pronësore 10397 KK SARAJ Shkup.

Ndërtesa nr. 3 me sipërfaqe prej **143 m2** në përdhese, qëllimi NPSH, e evidentuar në PK 10337 në Listën pronësore 10397 KK SARAJ Shkup.

Ndërtesa nr. 4 me sipërfaqe prej **398 m2** në përdhese, qëllimi HA, e evidentuar në PK 10337 në Listën pronësore 10397 KK SARAJ Shkup.

Ndërtesa nr. 6 me sipërfaqe prej **8 m2** në përdhese, qëllimi NPSH, e evidentuar në PK 10337 në Listën pronësore 10397 KK SARAJ Shkup.

Shuma e vlerësuar e pronës lëndë e shitjes është 18.382.440,00 denarë.

Prona shitet sipas sistemit e parë – e blerë. Reklamacione shtesë nuk pranohen. Për pjesëmarrje në e-ankand, pjesëmarrësit janë të OBLIGUAR të paguajnë depozitë në shumë prej 10% të shumës së vlerësuar, më së voni deri më 18.12.2017. Depozita paguhet në llogari të EMO SHA Ohër në falimentim, xhiro llogaria 210-0408690266-61 NLB-Tutunska Banka – Shkup NVT 4020990105397, me shenjë “për pjesëmarrje në e-ankand në shpalljen me nr. 46”. Çmimi fillestar është 0,00 denarë (NUK FILLOHET ME SHUMËN E VLERËSUAR). E-ankandi do të mbahet më datë 20.12.2017 me fillim në ora 12,00 dhe do të zgjasë 30 minuta deri në ora 12.30. Patundshmëritë të cilat janë lëndë e shitjes elektronike mund të shihen çdo ditë deri më datën 18.12.2017 prej ora 10 deri në ora 13 me paralajmërim paraprak tek drejtori për falimentim. Gjykatësi për falimentim në afat prej 15 ditëve nga dita e shitjes së realizuar elektronike, nëse nuk arrihet shuma e vlerësuar fton Kuvendin e kreditorëve, i cili sjellë Vendim nëse pronë do të shitet me çmimin e arritur. Gjatë vendosjes për shitje të pronës lëndë e shpalljes shqyrtohet oferta me e lartë e arritur në e-ankand pavarësisht nëse ai është më i vogël se shuma e vlerësuar.

Në rast kur Kuvendi i kreditorëve nuk është mbajtur, Gjykatësi i falimentimit në bazë të lajmërimit me shkrim në afat prej 3 ditëve pas cilës do të të Kuvendit të thirrur të kreditorëve sjellë vendim për shitjen e realizuar dhe obligon blerësin të paguajë shumën e çmimit të arritur. Pas pagesës së realizuar të shumës së çmimit të arritur, gjykatësi i falimentimit në afat prej 3 ditëve sjellë vendim me të cilin konstaton se pronë është shitur, i cili vendim paraqet bazën për transferim të pronësisë dhe regjistrim të librat publik. Pjesëmarrësve të cilëve nuk do t’u pranohet oferta, depozita e paguar do t’u kthehet në afat prej 3 (tre) ditëve duke konsideruar nga dita e përfundimit të E-ankandit, përveç pjesëmarrësit oferta e të cilët do të jetë fituese në e-ankand. Të gjitha tatime dhe pagesat e tjera që kanë të bëjnë me shitjen e pronës/TVSH që nuk është i kalkuluar në çmim, tatimi i qarkullimit të patundshmërive dhe tatime të tjera, aktet materiale, katastrale, të avokaturës dhe të tjera i paguan blerësi.

Informacione më të hollësishme tek drejtori për falimentim në tel. 070-694-752

Vizioni amerikan, i drejtë

Nga Festim POLLOZHANI



Historia na ka mësuar se “peshku i madh e han të voglin”. Në fakt kjo thënie është e përgjithshme dhe ka kuptim më të gjerë, por nëse ndjekim metodën e deduksionit, kjo thënie mund të shërbejë si orientim sidomos për ne shqiptarët. Jo rrallëherë kemi qenë në pozitë të palakmueshme, herë si pasojë e konstelacioneve të gjeopolitike dhe herë si pasojë e orientimit të gabuar politik dhe strategjik por mbi të gjitha sepse në një mënyrë ose një tjetër figurativisht si popull, jemi një “peshku i vogël” dhe për më tepër nuk jemi të ngjashëm me ndonjë popull tjetër fqinj, ose familje popujsh siç janë për shembull sllavët, ose më larg nesh arabët. Çështje e vërteta, historia na ka gjetur të pa përgatitur si komb, na ka gjetur pa shtet të konsoliduar dhe pasojat janë ato që janë. Nga ana tjetër, më duket se SHBA – të janë aleatët ose përkrahësit që kanë parandaluar që punët të shkojnë edhe më keq, bile në historinë e shekullit XX – SHBA-të kanë qenë aleati ynë më i fuqishëm, një mrekulli e paqes kjo që vazhdon edhe sot. Nuk duhet ta harrojmë kontributin e ish presidentit amerikan Wilson, dhe angazhimin e tij politik në fillim të shekullit të kaluar që shteti i sapo krijuar shqiptar të mos copëtohej. Vizioni i ish presidentit amerikan, interesi për të mirën e popujve të vegjël në Evropë të cilët nuk ishin marrë parasysh nga fuqitë e mëdha, përveç se një politikë vizionare për sa i takon botëkuptimet ishte edhe një shqetësim konkret për popuj të caktuar dhe sidomos për shqiptarët, duke e mbështetur vizionin e tij politik mbi parimin e vetëvendosjes së popujve. Natyrisht se rol të rëndësishëm në atë kohë ka luajtur edhe diaspora shqiptare në SHBA e udhëhequr nga Faik Konica dhe Fan Noli, por edhe të tjerë si Kostë Çerkezi dhe Kristo Dako (bashkëshorti i Sevasti Qiriazit). Pra, dy elemente ndërlidhen këtu, përveç parimit për vetëvendosje - i lansuar nga presidenti amerikan Wilson, janë edhe kontaktet shqiptaro – amerikane që pamundësuan copëtimin e Shqipërisë në atë kohë.

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë ndër fuqitë më të mëdha politike, ekonomike dhe ushtarake në botë, për të mos thënë fuqia më e madhe dhe natyrisht se janë përf-

shirë në shumë procese, që kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes dhe stabilitetit politik kudo nëpër botë. Janë angazhuar edhe si ndërmjetësues për zgjidhjen e kontesteve mes popujve të ndryshëm anekënd botës. Rasti më aktual është ai mes Izraelit dhe Palestinës në lidhje me qytetin e Jerusalemit, një vendim politik i rëndësishëm i SHBA –ve që sipas gjasave ngjalli shumë reagime, të ndara në dy pjesë, përkrahës dhe kundërshtues të idesë dhe vizionit amerikan. Ne shqiptarët qoftë si komb, ose në vijë institucionale dhe shtetërore nuk besoj se kemi kapacitetin ose informatat të vlerësojmë se cili vendim është i drejtë dhe cili jo. Për më tepër ky rast nuk ka asnjë lidhje me proceset tona politike si komb për konsolidimin e shteteve tona në Ballkan. Ne duhet të besojmë në vizionin amerikan, siç kemi besuar deri tani dhe në mënyrë të heshtur ta përkrahim atë, për aq mundësi sa kemi. Nuk e kemi ne luksin për të ndërhyrë në konteste aq të mëdha politike, siç është kontesti izraelito – palestinez. Thjeshtë duhet të kemi besim tek SHBA – të si shtet

që kujdeset për ruajtjen e paqes nëpër botë, dhe kujdesin për fatin e shteteve të vogla, natyrisht bazuar edhe në këndvështrimin e tyre.

Mos harrojmë se pas rënies së komunizimit në Evropë dhe shpërbërjes së Jugosllavisë, kontributi politik i SHBA-ve ishte vendimtar, sidomos në vendosjen e paqes në Bosnjë dhe pastaj përcaktimin e fatit të Kosovës duke u përfshirë në mënyrë direkte edhe ushtarakisht në atë konflikt. A ka një skemë amerikane për Ballkanin?! Sigurisht që mund të ketë, sepse ata kanë investuar për atë skemë, dhe ne duhet të kemi besim tek amerikanët. Një argument për këtë është mbështetja politike amerikane për konsolidimin e Shqipërisë si shtet, që kulmoi me anëtarësimin në NATO, gjë që u cilësua si “miracle of freedom”.

Gjithashtu mbështetja politike e amerikanëve pas luftës së Kosovës, si në pavarësimin e saj si shtet, ashtu edhe në negociatat me shtetin serb por edhe njohjen ndërkombëtare të Ko-

Shtetet e Bashkuara të Amerikës janë ndër fuqitë më të mëdha politike, ekonomike dhe ushtarake në botë, për të mos thënë fuqia më e madhe dhe natyrisht se janë përfshirë në shumë procese, që kanë të bëjnë me ruajtjen e paqes dhe stabilitetit politik kudo nëpër botë



sovës ka qenë e rëndësishme veçantë. Askush nuk dyshon se shqiptarët janë populli më pro-amerikan në Ballkan, ndoshta edhe më gjerë, kujtoj pritjen entuziaste që ju bë ish presidentit Bush në Fushë-Krujë, ose ndërtime të ish presidentit Clinton në Prishtinë.

Çështja është se duhet të jemi të gatshëm të sakrifikojmë nga vetja edhe me veprime politike, për ta treguar mbështetjen ndaj SHBA – ve. Duhet të besojmë në vizionin amerikan edhe në rastin e demarkacionit të Kosovës, gjegjësisht caktimin e kufirit me Malin e Zi, duke pasur parasysh se në Mal të Zi jetojnë një numër i konsiderueshëm i shqiptarëve dhe vizioni amerikan mund të jetë përtej horizontit tonë politik, të cilit ne duhet ti besojmë.

Duhet të mësohemi të nojtojmë në krah të “peshkut të madh”, duke treguar vigjilencë politike, siç kanë treguar figurat politike shqiptare që i përmenda pak më lartë. Unë besoj në vizionin e SHBA -ve, ai është i drejtë.

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovësia lok.14 - përtheshë, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e diel 10 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006

Drejtor: Lirim DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndhimskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA

E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221

Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772



Mustafi nuk ia del me lëndimin

Mbrojtësi shqiptar, Shkodran Mustafi nuk ia ka dalë që të bëhet gati për ndeshjen me Sautemptonin, që u zhvillua dje. Në ndeshjen e javës së kaluar ndaj Manchester Junajtedit, Mustafi pësoi një lëndim në këmbën e djathtë dhe u detyrua të zëvendësohet. Trajneri francez i Arsenalit, Arsen Wenger kishte deklaruar gjatë javës se Mustafi do të ishte i gatshëm për të dielën, por një gjë e tillë nuk ndodhi, pasi reprezentuesi i Gjermanisë nuk ka arritur të kalojë lëndimin për tu rikthyer në fushë. Cekim, 25-vjeçari ka qenë lojtari më i mirë në mbrojtjen e Arsenalit këtë edicion.

PUNOJ PËR TË ARRITUR KOMBËTAREN E PANUÇIT

"Kam shumë dëshirë të jem gjithmonë pjesë e Shqipërisë. Jam në rrugën për t'u përgatitur për t'u kthyer dhe besoj se do të jem pjesë e Kombëtares" u shpreh Seferi

Taulant Seferi nga Kumanova, aktualisht është pjesë e shpresave U-21, ndërsa së fundmi për mediat nga Shqipëria ka folur për mundësinë që ai të bëhet pjesë e Kombëtares më të mirë. Seferi shprehu dëshirën e tij për të qenë pjesë e skuadrës së Kristian Panuçit. Cekim, ai hyri në histori si lojtari më i ri që ka debutuar me ngjyrat e kësaj fanelle, por pavarësisht këtij fakti, ai zgjodhi të vazhonte aventurën tek kuqezinjtë. "Kam shumë dëshirë të jem gjithmonë pjesë e Shqipërisë. Jam në rrugën për t'u përgatitur për t'u kthyer dhe besoj se do të jem pjesë e Kombëtares" u shpreh sulmuesi në një prononcim për "Super Sport". Seferi, aktualisht është pjesë e skuadrës së Jang Bojss, por prej javësh po qëndron larg fushave të blerta për shkak se është i dëmtuar. Sidoqoftë 21-vjeçari u shpreh se ai do të jetë gati për gjysmën e dytë të sezonit. "Për dy javë kthehem me ekipin dhe gjysmë-sezonin e dytë do të jem në 100 për qind të formës time", tha Seferi.

Mesfushori kuqezi nuk ka mundur dot të jetë në fushë në dy betejat ndaj Skënderbeut, gjithsesi ai komplimenton korçarët për paraqitjet e bëra.

"Jam shumë i lumtur që ekipi më i madh shqiptar ka luajtur në Liga Evropë dhe është paraqitur edhe mire" përfundoi Seferi, ish-futbollisti i Milanos dhe Rabotniçkit.

LAJME SHKURT

Veseli dhe Osmani, të artë në Herceg Novi

Shkup, 10 dhjetor - Doan Osmani është shpallur për herë të dytë kampion Ballkanik, pas atij në vitin 2012. Në kategorinë U21 në kampionatin për kadet dhe junior që u mbajt në Herceg Novi të Malit të Zi, karateisti nga Gostivari në luftën finale deri në 75 kg mundi malazezin Nikola Malović. Para se të arrijë në finale, Osmani mposhti malazezin Babiç, kosovarin Shabani, Brkiç nga BeH dhe serbit Mariç. Derisa, medalje të arrit fitoi edhe Faik Veseli (-61 kg). Ndryshe, nga garuesit shqiptar të përfaqësueses së Maqedonisë, medalje të argjenditë fitoi Ardit Marku (+76 kg U 21) dhe Krenar Xhaferi (-60 kg, U 21) si dhe Abdurahim Idrizi në kategorinë (-55 kg junior)

"Liria" fiton dy medalje të bronza në Dimitrovgrad

Shkup, 10 dhjetor - Në Dimitrovgrad të Bullgarisë, gjatë ditës së shtunën u organizua turneu i radhës për fëmijë, "Enco Velcev", në të cilin nga Maqedonia edhe njëherë ishte ftuar Klubi i Mundjes "Liria". Klubi më i suksesshëm shqiptar mori pjesë me pesë mundës të cilët u udhëhoqën nga trajnerët Sufijan Ismaili dhe Bujamin Ebipi. Më të suksesshëm ishin Abdullah Xhemali dhe Ensar Bela, të cilët fituan medalje të bronza në kategoritë deri më 30 kg dhe 33 kg, ndërsa Omer Memedi ishte i pesti në kategorinë deri më 37 kg.

Shkupi humb nga Kumanova

Shkup, 10 dhjetor - Basketbollistët e Shkupit kanë pësuar disfatë para dashamirëve të saj nga skuadra e KB Kumanova me rezultatin 69:95. Bardhekaltërit kanë qenë kundërshtar i barabartë vetëm në çerekun e parë kur kishin negative prej vetëm një pikë (17-18), derisa në tre çereket tjera dështuan (12:25, 14:24 dhe 16:29) dhe në fund pësuan disfatë me 26 pikëve diferencë. Janevski te mysafirët shënoi 16 pikë, me nga 15 ishin Karakolev dhe Milkoviç, ndërsa për Shkupin figurë e vetme e ndritur ishte Xhozef Tejllor që shënoi 23 pikë dhe kishte 17 kërcime, ndërsa 19 pikë shënoi edhe Tajron Heris.

Vardari fiton njëherë nga dy ndeshjet e mbetura

Shkup, 10 dhjetor - Kampioni aktual Vardari ka mposhtur me rezultatin 3-1 'Akademija Pandev', në kuadër të ndeshjes së mbetur të javës së 17-të në Ligën e parë futbolistike të Maqedonisë, e cila u zhvillua dje në "Filipi i dytë". Dejan Bllazhevski dhe në dy herë Hambarxhumjan, ishin autor të golave për Vardarin, ndërsa golin e vetëm për mysafirët e shënoi Jani Atanasov. Pas kësaj fitore Vardari ka 35 pikë (një ndeshje më pak) 11 më pak se Shkëndija. Ndeshjen tjetër të mbetur Vardari do ta zhvillojë më 13 dhjetor në ora 13 kundër Rabotniçkit.



Kosova do të merr pjesë në Rusi



Kosova, megjithatë do të merr pjesë në Xhudo Masters në Rusi. Kështu ka njoftuar trajneri i përfaqësueses së Kosovës në xhudo, Driton Kuka. Ai ka bërë të ditur se kreu i Federatës Ndërkombëtare të Xhudos, Marius Vizeri ka bërë të ditur kreut të Federatës së Xhudos së Kosovës, Agron Kuka, se xhudistet tona do të marrin pjesë në "The Best of the Best", që do të mbahet në Shën Petersburg të Rusisë. "Presidenti Vizeri ishte njeriu që me angazhimin e tij dhe bisedat që kishte me njerëz nga Komuniteti sportiv por edhe politik të shtetit Rus për-

sëri bëri që Kosova të prezantohet e barabartë me shtetet tjera! Falënderim i madh të gjithë atyre që mundësuan të jemi të barabartë me shtetet tjera!", ka shkruar Kuka në "Facebook". Kosova do të merr pjesë në këtë turne me xhudistet Nora Gjakova dhe Distria Krasniqi. Ditë më parë, Kosovës i ishte refuzuar pjesëmarrja me simbole shtetërore dhe FXHK nuk kishte pranuar të marr pjesë me flamurin e Federatës Botërore në këtë turne. Kujtojmë se turneu do të zgjat vetëm dy ditë dhe do të mbahet më 16 dhe 17 dhjetor.

JASIN RAMADANI, ANËTAR I SWIMMING LIRIA"

RAMADANI, DJALI QË FLUTURON MBI UJË

Ndryshe, "Swimming Liria" është formuar para dy viteve, por që ka arritur që në krye me trajnerin Faton Ganiu dhe Avni Musliu të nxjerrin talent, të cilët shihen si e ardhmja e notit në Maqedoni. Në mesin e atyre talenteve që kanë një të ardhme të ndritur është edhe Jasin Ramadani nga Studeniçani i Shkupit. 16-vjeçari është njëri prej notuesve më të talentuar nga Maqedonia

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 10 dhjetor - Në një vend si Maqedonia ku sportet si futboll, mundja, boksi, karateja janë të përfshira më së shumti, shumë shpesh lëmë anash disiplina të tilla si noti në të cilën tani më ekziston klubi i notit "Swimming Liria" nga Shkupi. Ndryshe, "Swimming Liria" është formuar para dy viteve, por që ka arritur që në krye me trajnerin Faton Ganiu dhe Avni Musliu të nxjerrin talent, të cilët shihen si e ardhmja e notit në Maqedoni. Në mesin e atyre talenteve që kanë një të ardhme të ndritur është edhe Jasin Ramadani nga Studeniçani i Shkupit. 16-vjeçari është njëri prej notuesve më të talentuar nga Maqedonia, ndërsa për gazetën KOHA, rrëfen hapat e parë me notin, sukseset, disiplinën në të cilën garon dhe dëshirat e tij. "Hapat e parë me sportin e notit i kam bërë para pesë viteve te klubi i notit 'Swimming Noti' ku trajner ishte Faton Ganiu. Aty kam qëndruar dy vite dhe më pas kalove ta klubi i notit 'Swimming Liria' ku edhe sot jam pjesë e saj. Arsyeja për tu marr me këtë sport ishte e thjeshtë, doja të mësoj të notoj ndërsa për këtë insistuan edhe prindërit e mi. Arsyeja tjetër ishte se sporti i notit është një sport i veçantë me vet faktin që zhvillohet në një ambient jo naty-



ror të njeriut dhe mendoj në përgjithësi notarët janë ndryshe nga sportistët e tjerë, sepse dallojnë edhe për nga karakteri. Është një botë tjetër, ndryshe nga jeta në të cilën e zhvillojmë në tokë, uji dhe notit përveç të gjitha benefiteve, që na dhurojnë në aspektin fizik, na japin një freski mendore dhe shpirtërore, është ndjenjë e mrekullueshme kur jam në ujë", shprehet Ramadani.

MEDALJA E PARË NË MARATONËN E DOJRANIT

Momenti i parë kulmor për Jasinin ndodhi në Maratonën e Dojranit, pas pjesëmarrjeve në gara të ndryshme, nga e cila 16-vjeçari Ramadani ka dal i kënaqur me rezultatet që i ka arritur. "Deri më tani kam marrë pjesë në shumë gara dhe nga secila garë kam dal i kënaqur me rezultatet që i kam arritur. Mirëpo, medaljen e parë arrita ta fitoj në Maratonën e Dojranit ku arrita të bëj një garë prej 2,5 km me kohe 43:25:1 dhe të fitoj medaljen e argjendtë. Gara e radhës ishte ajo Republikane në 800 metra stil i lirë, ku arrita të fitoj medaljen e bronzit me kohë prej 11.45.13, rezultat ky i cili për mua personalisht por edhe për klubin dhe trajnerin ishte një gëzim i madh pasi kjo ishte hera e parë që një garues shqiptar nga një klub shqiptar të fitojë medalje. Më pas pasuan gara ndërkombëtare në Ksamil të Shqipërisë, ku arrita të fitojë vendin e dytë (6 kilometra stil i lirë) ndërsa njëkohësisht u shpalla si notuesi më i ri në këtë eveniment, pastaj Maratona e vogël e Ohrit (2,5 km) vendi i pestë, Gara Ndërkombëtare "Delfin Kup" ku mora medalje të argjend (200 metra bretkosë), Gara Ndërkombëtare në Shkup në "Beta Kup" medalje të bronzit, ndërkohë që gara e fundit e këtij viti u mbajt në Tiranë, ku arrita të përmirësoj kohën time personale dhe gjithashtu t'i afrohem rekordit të Maqedonisë", shtoi më tej Ramadani.

STILI I LIRË, "DELFIN" DHE SHPINË, STILET E PREFERUARA

Jasini noton të gjitha stilet e notit, por kohëve të fundit ai prezantohet me stilin e lirë, "del-

Sporti i notit është një sport i veçantë me vet faktin që zhvillohet në një ambient jo natyror të njeriut dhe mendoj në përgjithësi notarët janë ndryshe nga sportistët e tjerë, sepse dallojnë edhe për nga karakteri. Është një botë tjetër, ndryshe nga jeta në të cilën e zhvillojmë në tokë, uji dhe notit përveç të gjitha benefiteve, që na dhurojnë në aspektin fizik, na japin një freski mendore dhe shpirtërore, është ndjenjë e mrekullueshme kur jam në ujë



Hapat e parë me sportin e notit i kam bërë para pesë viteve te klubi i notit 'Swimming Noti' ku trajner ishte Faton Ganiu. Aty kam qëndruar dy vite dhe më pas kalove ta klubi i notit 'Swimming Liria' ku edhe sot jam pjesë e saj. Arsyeja për tu marr me këtë sport ishte e thjeshtë, doja të mësoj të notoj ndërsa për këtë insistuan edhe prindërit e mi.

fin" dhe shpinë. "Normal garoj edhe nëpër disiplinën tjetra dhe distanca të ndryshme, por kohëve të fundit jam bazuar në ato ku unë dhe trajneri mendojmë se jemi më të mirë, pra në stilin e lirë, 'delfin' dhe shpinë".

PJESËMARRJA NË OLIMPIADË, DËSHIRA E MADHE E JASINIT


Të gjithë sportistët kanë nga një dëshirë, ndërsa një gjë të tillë e ka edhe Jasini. "Dëshira ime është që ta përfaqësoj vendin tim dhe kombin tim normal në Arenat Ndërkombëtare. Por më e rëndësishmja është që një ditë të marr pjesë në Lojërat Olimpikë në not ku do të bëhem shqiptari i parë nga Maqedonia që do të merr pjesë në LO në këtë sport. Kur jemi te sporti i notit dua të përmend edhe faktin se noti në përgjithësi tek ne nuk është shumë i zhvilluar, por falë disa klubeve ku marrim pjesë edhe ne të klubi të notit 'LIRIA' ka filluar që të ndihet një erë e re e sportit të notit në Maqedoni".

FELPS, NOTUESI MË I PREFERUAR

Kur bëhet fjalë për notin edhe Jasini ka notuesit e preferuar, të cilët e frymëzojnë gjithmonë. "Notuesi im më i preferuar është amerikanin Majkell Felps, notuesi më i suksesshëm i të gjitha kohërave. Normalisht se atë e kam si një pikë synim", përfundoi Jasin Ramadani.

I DUAN KLUBET E MËDHA

Vera e ardhshme do të prodhojë një “domino” real në futbollin evropian për portierët. Klubet e mëdha, ekonomikisht të fuqishme, po kërkojnë një të tillë dhe do të ketë shumë lëvizje



NJË VERË ME “EFEKT DOMINO” MES PORTIERËVE

Real Madridi dhe PSZH-ja duket të jenë të parët për të lëvizur. Klubi i bardhë, edhe tani mund ta bënte atë në merkaton e dimrit, pa pritur për fundin e sezonit. Gjatë rrugës, “Los Blancos” do të paguajë klauzolën e Kepa Arrizabalaga tek Atletik. Portieri bask do t’iu bashkojë urdhrave të Zinedin Zidane së bashku me Kejlor Navas dhe Kiko Kasilla. Mbetet për t’u parë nëse “gardiani” nga Kosta Rika do të mbetet në “Bernabeu”, ose do të mbërrinte një portier shumë i madh, si David de Gea (Manchester Junajted), apo Thibaut Kurtoa (Çellsin).

Klubi tjetër që kërkon të sigurojë portën e tij është PSZH-ja, i cili ka vendosur sytë tek i shkëlqyeri Jan Oblak, pjesë e Atletiko Madrid. Presidenti i klubit parisien, Nasser El Khelaifi, nuk mendon se portieri i tanishëm, france-

zi Alfons Areola, pavarësisht nga cilësitë e tij, nuk është në lartësinë e duhur për më të mirët në Evropë dhe për të arritur sukses në Ligën e Kampionëve. Ai bind edhe më pak trajnerin Unai Emery. Edhe Kevin Trapp ka pasur një performancë të parregullt. Gjermani, i cili erdhi nga A인트 Frankfurt, nuk jep siguri, gjithashtu. Problemi për PSZH-në është se Jan Oblak ka një klauzolë prej 100 milionë eurosh. Për Jan Oblak ishte, gjithashtu, i interesuar edhe Juventus, i cili kërkon të zëvendësojë mitikun Buffon. Dhe më parë, menaxheri i tij, Miha Mlakar, kontaktoi “qytetarët” e Pep Guardiols, që tashmë duket se kanë gjetur garanci tek i riu brazilian, Ederson Moraes. Manchester Siti ka ruajtur edhe kontrollin mbi Geronimo Rulli (Real Sociedad), që kushton 14 milionë euro. Kohët e fundit, tekniku bardhezi, Massi-

milano Alegri, duket i bindur për mundësitë e portierit të tij polak, Wojciech Szczęsny, i cili erdhi nga Roma për “vetëm” 12 milionë euro, pas shkëlqimit me klubin e kryeqytetit italian, ku mbërriti nga Arsenali, sepse “topçinjtë” nënshkruan me Petr Çeh.

OBJEKTIVI I REAL MADRIDIT

Në rastin e David de Gea dhe Thibaut Kurtoas, të dy do të donin të ktheheshin në Madrid për arsye jo vetëm sportive. Të dy janë në fokusin e Real Madridit dhe kanë qenë shumë afër nënshkrimit me të, sidomos spanjollin ndërkombëtar, i cili pëlqehet shumë nga Zidane dhe dështoi në transferim vetëm për shkak të vonesës së një fakti. I dyti, madje, ka refuzuar të ripërtërijë kontratën me Çellsin, në përpjekje për të detyruar transferimin e tij te Real Madrid, ose Atleti, në të cilin ai luajti, si De

Gea, duke shpresuar që Jan Oblak do të lërë një vend bosh. Një tjetër klub i madh, që po bën një ndjekje diskrete të merkatos për portier, është Bayern Munihi. Dëmtimi i rëndë i Manuel Nojer e ka bërë të qartë se duhet një zëvendësues me cilësi më të lartë se aktuali, veterani Sven Ulrih, i shoqëruar nga të rinjtë Ron Thorben Hoffmann (18 vjeç), Kristian Fruç (17) dhe Leo Veinkauf (21). As nuk duhet të harrohet se Manuel Nojer është 31 vjeç. Për këtë arsye, bavarezët kanë bërë një studim të matur mbi Mark-Andre ter Shtegen, por 170 milionë euro klauzolë nga Barcelona duket një shifër e pakapërcyeshme, pa haruar se portieri i skuadrës katalanase ka thënë vetë: “Jo, faleminderit!” Holandezi Jasper Cillessen, portieri tjetër i Barcelonës, mund të jetë objektivi alternativ i bavarezëve.

ËNDRRA E NDALUAR

Ndërkombëtar i italian, Gianluigi Donnarumma (18 vjeç). Përveç cilësisë së tij të jashtëzakonshme, që e bën atë pasardhës në kombëtare të idhullit të tij, Gianluigi Buffon, ai ka Mino Raiola si menaxher. Në Itali thonë se kanë arritur një marrëveshje me klubin e Milanit, në mënyrë që mund të largohet nga kuqezinjtë për klauzolën e 60-70 milionë eurove. Kjo, sipas ekipit të Milanit, nëse portieri do të shkojë në Evropë në sezonin e ardhshëm. Juventus mundua për të, por pa sukses. Tani po flasin për interesimin e Real Madridit, me ndihmën e ish-menaxherit të Milanit, Adriano Galliani (mik i madh i Florentino Perez), çka mund të derivojë në goditjen përfundimtare dhe nënshkrimin me portierin e shkëlqyer, të lindur në “Castellammare di Stabia”.

SHKARKOHET PETER BOSH

Stoger, trajner i ri Dortmundit



Pas zërave të djeshme se Peter Bosh nuk është më trajneri i skuadrës së Borussia Dortmund, pak minuta më parë ka ardhur edhe zyrtarizimi. Klubi, përmes një komunikate zyrtare për mediat, ka konfirmuar largimin e tij nga detyra, duke shtuar se trajneri i ri i

skuadrës së Borussia është Peter Stoger. Ai do të drejtojë Dortmund deri në fund të sezonit. Bosz u ul në stolin e “verdhekuqve” gjatë verës së kaluar, pas një paraqitje të mirë me Ajaksin sezonin e kaluar, ku shkoi deri në finalen e “Europa League”. Por pas rezulta-

teve negative të javëve të fundit, teksa ka tetë javë që nuk shijon fitoren, rrugët e tij janë ndarë me ato të klubit gjerman. Bosh largohet duke mos lënë gjurmë në Bundesligë, teksa Borussia renditet në vendin e shtatë, ndërkohë që skuadra dështoi të avancojë edhe në “Champions League” (gjermanët u renditën në vendin e tretë në grup, pas Real Madrid dhe Totenhem), ndaj në shkurt do të luajë në “Europa League”. Në vendin e tij vjen Stoger, që një javë më parë u largua nga detyra e trajnerit të skuadrës së Kelnit, që ndodhet në fundin e renditjes, pa asnjë fitore këtë sezon të Bundesligës. Trajneri i ri e vlerësoi këtë detyrë të re, duke thënë se i jepet një mundësi e dytë këtë sezon, si shansi i jetës së tij.



“Santiago Bernabeu” nderon Ronaldon

Tifozët e Realit të Madridit kanë duartrokur gjatë yllin e tyre Kristiano Ronaldo, për fitoren e “Topit të Artë 2017”. Në “Santiago Bernabeu”, madriletë ndërruan Ronaldon para fillimit të sfidës me Sevilyën, me portugezin që shpali në fushën e blertë të 5 “Topat e Artë”, të fituar gjatë karrierës së tij. Ronaldo fitoi “Topin e Artë 2017”, në një ceremoni spektakolare të organizuar poshtë Kullës Aiffel, në Paris. Portugezi barazoi yllin argjentinas të Barçës, Lionel Messi, që gjithashtu e ka fituar 5 herë këtë trofe.

SPALETI I KËNAQUR ME LOJËN DHE REZULTATIN NDAJ JUVES



KY INTER ËSHTË

PËR TITULL

Fitore në Romë, barazim në Napoli dhe të shtunën një tjetër barazim në fushën e ekipit kampion të Italisë, Juventusit. Rezultate që lënë të mendosh se Interi i trajnerit Luçiano Spaletit këtë sezon mund të arrijë diçka më shumë se një vend në "Champions League". Këtë gjë e konfirmon vetë trajneri i skuadrës zikaltër. "Kur merr një pikë në fushën e Juventusit është një rezultat i rëndësishëm. Kjo skuadër ka kaluar 3 sezone të vështira dhe pas 15 javësh kampionat duket e pabesueshme që jemi në këto nivele. Mund të arrinim diçka më shumë ndaj Joves, por në disa momente na mungoi grinta para portës", shprehet Spaletti. Më tej, trajneri i Interit, duke folur për ndeshjen shton: "I kërkova skuadrës që të luajë e qetë, pa presion dhe kjo dha rezultat. Pati disa momente kur e humbëm shpejt topin, sidomos në pjesën e dytë, por në përgjithësi jam i kënaqur. Në pjesën e dytë mendoj se ishim ne ata që e komandam lojën, ndaj prisja diçka më shumë nga sulmi, golin e fitores. Ne tani jemi në një nivel tjetër, kemi kaluar nga skuadra që kishim fat në skuadrën që mund të fitojë kampionatin", deklaroi trajneri zikaltër, që ka mbetur i kënaqur nga rezultat e deritanishme të skuadrës, që kryeson renditjen e Serisë A me 40 pikë, dy më shumë se Juventusit e Napoli (ky i fundit luan dje ndaj Fiorentinës).

Pavarësisht se mungoi fitorja, trajneri Masimiliano Allegri ka mbetur i kënaqur nga paraqitja e skuadrës së tij në ndeshjen ndaj Interit. "Dua të përgëzoj lojtarët, që bënë një ndeshje të mirë, duke mos e lejuar kundërshtarit të gjuajë asnjëherë



Samir Handanović

Ishte me rëndësi që morëm këtë pikë, barazuam në duelin kokë më kokë dhe ishte me rëndësi të mos pësonim humbje. Kemi mundur të bënim më shumë. Pjesa e parë ishte më e mirë, por në pjesën e dytë ata ishin më të mirë pasi ne humbëm shumë topa. Ata luajtën më mirë në pjesën e dytë, por edhe ne kemi mundur të bëjmë më shumë. Ata kanë fituar shumë në vitet e fundit dhe tash janë ekipi më i kompletuar. Ishte me rëndësi që nuk humbëm, jemi ekip i fortë dhe kjo vlen



Miralem Pjanić

Zhënjimi i ekipit në zhveshtore ishte evident, pasi që ne ishim skuadra më e fortë në fushë dhe nuk shfrytëzuam rastet tona. Interi është skuadër e mirë, ka cilësi dhe unë e di punën që bën Spaletti. Është mëkat, pasi ishim superiorë dhe kemi mundur të bëjmë më shumë për të fituar. Tash duhet të shkojmë përpara dhe të grumbullojmë pikë tjera, pasi shoh se kemi humbur dy pikë. Ne duam të vazhdojmë të dominojmë në Serie A, ne e duam këtë Skudeto të shtatë rresht dhe do të japim gjithçka

Rezultate që lënë të mendosh se Interi i trajnerit Luçiano Spaletit këtë sezon mund të arrijë diçka më shumë se një vend në "Champions League". Këtë gjë e konfirmon vetë trajneri i skuadrës zikaltër Luçiano Spaletti

në portën tonë. Nuk ishte e lehtë, pasi Interi është një ekip kompakt, i aftë teknikisht. Na mungoi vetëm goli. Më vjen keq që nuk morëm 3 pikët, që do të na jepnin më shumë besim për të ardhmen, por jemi në rrugën e duhur", tha Allegri. Ai mendon se kjo ndeshje tregoi edhe një herë se Juventusit është një ekip i fortë dhe kompakt, që edhe këtë vit mund të fitojë kampionatin. "Në fazën mbrojtëse ishim të shkëlqyer, duke mos lejuar Interin të krosojë, pasi përballë kishim skuadrën që ka bërë më shumë krosime në kampionat. Por nuk ishim të tillë në çdo repart dhe në çdo moment, ndaj mendoj se mund të përmirësohemi ende. Interi dhe Juventusit do të duelojnë mes tyre deri në fund të sezonit për titull. Unë kam përshtypjen se skuadra ime nuk është ende në majë, por vijmë nga një periudhë e ngjeshur me ndeshje të vështira, ndaj jam i kënaqur", deklaroi Allegri.

RONALDO DHE RAMOS JAPIN BEKIMIN PËR TRANSFERIMIN

Bonuçi drejt Madridit

Nga Spanja vijojnë të qarkullojnë zërat se Leonardo Bonuçi mund të transferohet te Real Madrid verën e ardhshme. Sipas të përditshmes "OK Diario", skuadra e presidentit Florentino Perez është shumë pranë marrëveshjes me mbrojtësin e Milanit, transferim që mund të ishte realizuar edhe verën e kaluar. Lojtari i është ofruar "los blancos" pas largimit të Pepe, por në fund Reali vendosi të besojë te Varane. Por tashmë situata ka ndryshuar dhe duke parë problemet e shpeshta muskulore që ka francezi, skuadra "merengues" ka vendosur t'i besojë përvojës së Bonuçit. Ky transferim shihet me optimizëm dhe ka marrë miratimin edhe të lojtarëve kryesorë të Real Madrid, që e konsiderojnë ardhjen e mbrojtësit italian si një përforsim me vlera, duke parë përvojën e tij. Bonuçi ka një marrëdhënie shumë të mirë me mbrojtësin Sergio Ramos, ndërkohë që edhe Kristiano Ronaldo e konsideron italianin si një nga mbrojtësit më të fortë në botë. Problemi i vetëm mbetet Milani, që nuk preferon të shesë lojtarin, por në rast se kuqezinjtë nuk kualifikohen në "Champions League" sezonin

tjetër, atëherë situata mund të ndryshojë në favor të Bonuçit.



KUTINJO BËN PAKT ME LIVERPULIN

QËNDRON NË JANAR, POR IKËN VERËN E ARDHSHME



Filip Kutinjo kërkon garanci nga Liverpooli se do ta lejojë të largohet te skuadra e Barcelonës verën e ardhshme, pas dështimit të këtij transferimi në verën e këtij viti. Pronarët e "Anfield" refuzuan këtë verë një ofertë zyrtare prej 114 milionë sterlinash nga klubi katalanas (në fakt kanë qenë 3 oferta, gjithnjë në rritje financiarisht), duke vënë veton dhe duke mbajtur në skuadër sulmuesin brazilian.

Por Barcelona nuk ka hequr asnjëherë dorë nga transferimi i Filip Kutinjo dhe spanjollët janë gati të hidhen sërish në sulm edhe në merkaton e janarit. Por transferimi në janar duket i vështirë, duke qenë se braziliani nuk do të ketë mundësi të luajë në Çampions me katalanasit, ndaj ai ka rënë dakord që ta mbyllë sezonin me Liverpoolin, por me kusht që ata ta lënë të lirë verën e ardh-

shme. Kutinjo e di shumë mirë se skuadra spanjolle nuk do ta presë përjetësisht, ndaj është duke lëvizur vetë që situata të jetë në favorin e tij kur të kryhet transferimi. Sulmuesi 25-vjeçar konsiderohet si përforsimi i duhur për skuadrën e Barcelonës, ndaj dhe ai kërkon me çdo kusht të ndryshojë fanellë, duke arritur një marrëveshje paraprake me pronarët e Liverpoolit.

Koha, e hënë 11 dhjetor, 2017



JERUSALEMI,

Që nga okupimi britanik i Jerusalemit në vitin 1917, trojet palestineze u përballët me migrim hebre nga katër anët e botës. Me deklaratën e Ministrit të Jashtëm britanik Arthur Balfour në vitin 1917, u dha leja për krijimin e një shteti izraelit në trojet palestineze dhe Jerusalem, i cili llogaritet i shenjtë nga tri fetë qiellore

ÇËSHTJA E PAZGJIDHUR PREJ NJË SHEKULLI

Pas raportimeve për vendimin e presidentit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), Donald Trump, për njohjen e Jerusalemit si kryeqytet të Izraelit dhe zhvendosjen e ambasadës nga Tel Avivi në këtë qytet, në agjendën botërore sërish u vendos problemi mes Palestinës dhe Izraelit, i cili në vitin 1980 e shpalli Jerusalemin si "kryeqytet të përhershëm". Rëndësia e Jerusalemit ka vazhduar të rritet për muslimanët gjatë procesit që filloi me tërheqjen e Perandorisë Osmane dhe vendosjen e mandatit britanik. Jerusalemi, pjesë e trojeve historike palestineze, ishte qytet në të cilin gjatë qeverisjes osmane liri adhurimi kishin pjesëtarët e tri feve qiellore. Që nga okupimi britanik i Jerusalemit në vitin 1917, trojet palestineze u përballët me migrim hebre nga katër anët e botës. Me deklaratën e Ministrit të Jashtëm britanik Arthur Balfour në vitin 1917, u dha leja për krijimin e një shteti izraelit në trojet palestineze dhe Jerusalem, i cili llogaritet i shenjtë nga tri fetë qiellore.

Vende-vende, në Jerusalem ndodhën përleshje mes ushtrisë britanike dhe arabëve palestinezë, ndërsa në vitin 1920, qyteti u bë skenë e një kryengritjeje shoqërore. Ushtarët britanik e shtypën kryengritjen duke përdorur dhunë. Në Jerusalem, ku popullsia hebreje u rrit gjithnjë e më shumë, rreth 243 arabë dhe hebrenj humbën jetën në vitin 1929 në përleshjet që shpërthyen si pasojë e mosmarrëveshjes mes hebrenjve dhe muslimanëve për qasje në Murin Burak (Muri i Vajtimit). Gjendja në Jerusalemin e kontrolluar nga mandati britanik fitoi përmasa kërcënuese për muslimanët. Kështu, me iniciativë të myfitut të Jerusalemit Haxhi Emin el-Husejni, në vitin 1931 u organizua "Kongresi i Përgjithshëm

Islam", në të cilin morën pjesë 153 përfaqësues nga 22 vende islame, të cilët kundërshtuan vendimet e shteteve perëndimore dhe Lidhjes së Kombeve. Pas shpalljes së Jerusalemit si zonë ndërkombëtare sipas planit të ndarjes së Palestinës në kuadër të rezolutës 181 të Asamblesë së Përgjithshme të Kombeve të Bashkuara (OKB), në vitin 1947 në Jerusalem u organizuan protesta masive me thirrje të Komitetit të Lartë Arab.

Ndërkaq, Këshilli Nacional Hebre më 14 maj të vitit 1948 shpalli krijimin e shtetit izraelit në territorin historik palestinez. Në luftën që pasoi mes shteteve arabe dhe Izraelit pas shpalljes së në fjalë, Izraeli zgjeroni kufijtë në kundërshtim me planin e ndarjes së OKB-së së vitit 1947. Pas kësaj date, Jerusalemi Perëndimor kaloi nën administrimin izraelit, ndërsa Jerusalemi Lindor në atë të muslimanëve. Në vitin 1949, Izraeli e shpalli Jerusalemin Perëndimor kryeqytet të Izraelit, duke e zhvendosur parlamentin (Knesset) nga Tel Avivi në Jerusalem. Seanca e parë u mbajt më 14 shkurt të vitit 1949. Pas krijimit të shtetit izraelit, Jerusalemi i ndarë në dy pjesë, lindje dhe perëndim, nga viti 1948 deri në vitin 1967 u administrua nga dy shtete, Jordania dhe Izraeli. I kontrolluar nga Jordania, Jerusalemi Lindor u okupua nga Izraeli gjatë luftës gjashtëditore në vitin 1967.

Jerusalemi, i cili pas Mekes dhe Medines llogaritet qyteti i tretë i shenjtë në botën islame, si dhe vendet e shenjta islame në këtë qytet, u shënjestruan nga sulmet e hebrenjve fanatikë. Dennis Michael Rohan, hebre australian, më 21 gusht të vitit 1969 sulmoi Xhaminë Al Aksa, duke djegur murin jugor dhe minberin historik i cili ishte dhuruar nga Salahadin Ejubi, çliruesi i Jerusalemit para rreth një mijë viteve. Edhe krahas rinovimeve të ndryshme deri më sot, gjurmët e sulmit në fjalë ende nuk janë fshirë nga Xhamia Al Aksa. Presidenti i Egjiptit Enver Sedat u bë lideri i parë arab që pranoi Izraelin dhe kontrollin e tij mbi Jerusalemin, duke zhvilluar vizitë zyrtare në Izrael dhe Jerusalem në vitin 1977. Rreth dy vite pas kësaj, nën kryesimin e SHBA-ve, Egjipti

dhe Izraeli firmosën Marrëveshjen e Paqes në Camp David.

Pa kaluar shumë kohë nga marrëveshja në fjalë, parlamenti izraelit Knesset miratoi Ligjin për Jerusalemin në vitin 1980 duke e shpallur Jerusalemin e bashkuar, lindje dhe perëndim, si kryeqytet të Izraelit. Këshilli i Sigurimit i OKB-së (KS-OKB), nuk e njohu shpalljen e Jerusalemit si kryeqytet, përmes rezolutës 478 në vitin 1980. KS-OKB e kundërshtoi vendimin e Izraelit duke theksuar se "ligji në fjalë është i pavlefshëm dhe jodetyrues, dhe i njëjti duhet anuluar". Kompleksi Aksa dhe vakëfet në Jerusalem u lanë nën përkujdesjen e Autoritetit të Vakëfeve të Jerusalemit, që vepron nën Ministrinë jordaneze të Vakëfeve, Vendeve të Shenjta dhe Çështjeve Islame, sipas marrëveshjes së paqes mes Jordanisë dhe Izraelit të nënshkruar në Luginën Araba. Izraeli vazhdoi me shkeljet në Jerusalem, duke mos e njohur rezolutën e KS-OKB-së dhe duke e shpërfillur edhe marrëveshjen me Jordaninë. Më 25 shtator të vitit 1996, hapja e një tuneli në Murin

Burak (Murin e Vajtimit) në pjesën perëndimore të Al Aksasë në kuadër të gërmimeve izraelite në zonën e kompleksit Al Aksa, shkaktoi reagimin e palestinezëve. Në incidentet që zgjatën disa ditë, u vranë 63 palestinezë, ndërsa u plagosën një mijë e 600 të tjerë.

Qeveria palestineze dhe ajo izraelite, të cilat u takuan në Samitin e Camp Davidit të organizuar edhe një herë në vitin 2000 nën kryesimin e SHBA-ve, nuk arritën rezultat lidhur me statusin e Jerusalemit. Dy muaj pas Samitit të Camp Davidit, vizita që ish-kryeministri i Izraelit Ariel Sharon ia bëri kompleksit Al Aksa nën shoqërimin e qindra rojeve, u bë shkëndija e parë e intifadës së dytë që zgjati për disa vite. Që nga viti 2003, qeveria izraelite filloi të fusë nën mbrojtjes e saj kolonë hebrenj në oborrin e Kompleksit Aksa, ndërsa kohë pas kohe filloi të sjellë kufizime në moshë për hyrjen e muslimanëve. Shumë organizata dhe politikanë hebrenj radikalë bënë thirrje që kompleksi Aksa (Harem-i Sherif), në të cilin besojnë se gjendet tempulli i tyre që është rënë dy herë, të hapet për adhurim edhe për ta. Organizata për Arsim, Shkencë dhe Kulturë e OKB-së (UNESCO) më 18 tetor të vitit 2016 miratoi një rezolutë, përmes së cilës deklaroi se Kompleksi Aksa në Jerusalem nuk ka lidhje me Judaizmin. Presidenti amerikan, Donald Trump, gjatë fushatës zgjedhore presidenciale në vitin 2016 kishte premtuar se SHBA-të do ta zhvendosnin ambasadën nga Tel Avivi në Jerusalem. Ndërkaq, më 23 dhjetor të vitit 2016, KS-OKB, përmes një rezolute, kërkoi që Izraeli t'u japë fund "menjëherë dhe tërësisht" të gjitha aktiviteteve të paligjshme kolone në Jerusalemin Lindor të okupuar dhe territoret e tjera palestineze.

(Anadolu Agency)



KOALICIONI ME DY QËNDRIME PËR DEMARKACIONIN



Kuvendi i Kosovës ende nuk ka bërë të ditur, se kur marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi mund të vihet në rendin e ditës për votim, për të parë nëse kjo marrëveshje ratifikohet nga deputetët apo jo. Për ratifikimin e marrëveshjes së demarkacionit nevojiten 81 vota nga 120 deputetë që ka kuvendi i Kosovës. Qeveria dy ditë më parë e procedoi në kuvend për votim marrëveshjen së bashku me konstatimet e komisionit të ri për shënjimin e vijës kufitare i themeluar nga kryeministri Ramush Haradinaj. Por procedimi në kuvend i marrëveshjes ka nxjerrë në pah dallimet e thella brenda koalicionit qeveritar, që përbëhet nga Partia Demokratike e Kosovës, (PDK) Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës, (AAK) Nisma për Kosovën dhe lista Srpska. Vet kryeministri Ramush Haradinaj dhe partia e tij është kundër versionit aktual të demarkacionit dhe marrëveshja që ai e dërgoi për votim në kuvend është e qeverisë së kaluar të kryesuar nga ish-kryeministri Isa Mustafa. Kundër ratifikimit të kësaj marrëveshjeje është edhe Nisma për Kosovën, por edhe partia opozitare



Partneri më i madh i koalicionit aktual qeverisës, Kadri Veseli, kryetar i PDK-së, thotë se partia e tij do të votojë pro ratifikimit të marrëveshjes, sepse sipas tij, në këtë mënyrë forcohet sovraniteti i Republikës së Kosovës dhe kjo i hap rrugë liberalizimit të vizave

Vetëvendosje, e cila ka 32 deputet. Partneri më i madh i koalicionit aktual qeverisës, Kadri Veseli, kryetar i PDK-së, thotë se partia e tij do të votojë pro ratifikimit të marrëveshjes, sepse sipas tij, në këtë mënyrë forcohet sovraniteti i Republikës së Kosovës dhe kjo i hap rrugë liberalizimit të vizave. "Qëndrimi im, por edhe i subjektit tim që përfaqësoj është i qartë. Marrëveshja me Malin e Zi duhet të rati-

fikohet. Marrëveshja duhet të kalojë dhe vota jonë është 'pro', siç e kemi thënë në vazhdimësi. Gjithsesi, unë besoj se duhet të ketë një konsensus të plotë për këtë marrëveshje", shprehet Kadri Veseli, duke ritheksuar se Bashkimi Evropian duhet të veprojë shpejt dhe qartë sa i përket liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës. Është Bashkimi Evropian dhe përfaqësuesja e këtij mekanizmi në Kosovë, Natalya Apostolova, e cila u rikujton deputetëve të kuvendit të Kosovës, se çështja e shënjimit të kufirit me Malin e Zi duhet përfunduar, sepse është kusht për liberalizimin e vizave. Ajo thotë se "politikanët nuk duhet t'i mbajnë peng të rinjtë e Kosovës". "Dua t'u kujtoj edhe njëherë politikanëve që demarkacioni i kufirit me të vërtetë është thelbësor për t'u zgjidhur. Nuk dua që politikanët të mbajnë peng të rinjtë e Kosovës, një rini fantastike që meriton lëvizje të lirë, që ndoshta nuk iu kujtohet konflikti dhe duan të jenë pjesë e Evropës. Kërkoj nga të gjithë ata që do ta kenë rastin të votojnë të kenë këtë në mendje", thotë Natalya Apostolova në një konferencë,

ku u fol për integrimet e Kosovës. Pro ratifikimit të marrëveshjes së demarkacionit është shprehur Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), e cila madje akuzon qeverinë Haradinaj për izolim të qytetarëve të Kosovës duke bllokuar demarkacionin me Malin e Zi. Komisioni për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi i themeluar nga kryeministri Ramush Haradinaj, dy ditë më parë prezantoi raportin me konstatimet e tij për kufirin. Ata thanë se komisioni i kaluar ka gabuar në shënjimin e kësaj vije dhe vazhdojnë të mbajnë qëndrimin se Kosova me marrëveshjen e vitit 2015 me Malin e Zi humbet territor. Por, është ambasadori amerikan në Kosovë, Greg Delawie, i cili raportin e komisionit të qeverisë Haradinaj për kufirin e quajti "një grumbull broçkullash të tyre". Ai rikujtoi që ishin edhe ekspertët amerikanë nga State Departamenti, që në vitin 2016 e verifikuan marrëveshjen e demarkacionit të Kosovës me Malin e Zi dhe konstatuan, se me këtë marrëveshje Kosova nuk humbet territor. Sidoqoftë, analistët politikë thonë, se qeveria Haradinaj e

Kalimi në kuvend i marrëveshjes së demarkacionit ka nxjerrë në pah dallimet brenda koalicionit. Partnerët ndërkombëtarë: kuvendi duhet ta ratifikojë marrëveshjen. Analistët: mosratifikimi vë në pikëpyetje qeverinë

ka të vështirë të vazhdojë qeverisjen me këtë ndarje që ka brenda koalicionit rreth çështjes së demarkacionit. "Çështja e Demarkacionit nuk mund të mbetet pezull, duhet të ketë zgjidhje apo alternativa. Qeveria Haradinaj nuk guxon të thotë ne jemi kundër këtij formati të demarkacionit dhe në të njëjtën kohë ta dërgojë atë për miratim në kuvend". Qeveria e udhëhequr nga Ramush Haradinaj do të ketë probleme të mëdha edhe brenda koalicionit qeverisës, por edhe në raport me partnerët ndërkombëtarë, që ta arsyetojnë vazhdimësinë e qeverisjes, nëse nuk ka ide se si të ballafaqohet me problemin e demarkacionit", shprehet në një shkrim të tij, analisti Artan Muhaxheri. Deputetët e kuvendit të Kosovës tashmë e kanë në dorë marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi të nënshkruar në vitin 2015 nga qeveria e Isa Mustafës dhe po ashtu bashkangjitur edhe raportin e komisionit për shënjimin e vijës kufitare me Malin e Zi të kryeministrit Haradinaj, me të gjeturat që e kundërshtojnë marrëveshjen e parë. Kryesia e kuvendit ende nuk ka rënë dakord, se kur do ta verë në votim marrëveshjen e demarkacionit, mirëpo, siç u tha kjo do të ndodhë shumë shpejtë.

COSA NOSTRA KA NGRITUR NJË BAZË NË SHQIPËRI

Organizata më e fuqishme kriminale italiane "Cosa Nostra" ka ngritur bazat e saja në Shqipëri. Lajmi i bujshëm bëhet akoma edhe më alarmant kur burimi i tij nuk janë ato mediatike, që mund të kenë edhe doza spekulimi, por vetë ministri i Brendshëm italian, Marco Minniti. Sipas raportit të paraqitur në Parlamentin italian, nga ministri Minniti rezulton se të paktën një nga familjet mafioze siciliane ka hyrë në bashkëpunim të fuqishëm me trafikantë shqiptarë të drogës, duke ngritur edhe bazat e saj në Shqipëri. Ministri i Brendshëm i Italisë në raportin që i paraqet Parlamentit për punën e bërë nga Drejtoria e Anti-mafias për 6-mujorin e dytë të vitit 2016 disa herë përmend trafikantët shqiptarë të drogës si bashkëpunëtorë



të "Cosa Nostra"-s, por në faqet 64-65 përmendet një emër konkret. Sipas raportit një anëtar i familjes mafioze Carollo, nga Palermo, kishte ngritur një bandë e cila sillte kanabisin nga Shqipëria në Milano. "Edhe aktiviteti i trafikut të drogës është sektori që na ka lejuar, në këtë 6-mujor, të kuptojmë nga sinjalet e

marra shtrirje të aktivitetit të COSA NOSTRA edhe në Shqipëri. Gjatë operacionit "Rubens", i përfunduar në nëntor nga Policia e Shtetit, u kap një organizatë kriminale, me seli në Milano, aktive në importim e marihuanës nga Shqipëria ku merrte pjesë edhe djali i një anëtarit të familjes CAROLLO të Paler-

mos", thuhet në raportin e ministrit të Brendshëm të Italisë. Po kështu përmendet edhe një rast i identifikuar në nëntor të 2016, kur në Catania të Sicilisë u kap gati 1 ton kanabis. "Hetimet kanë bërë të mundur identifikimin e Shqipërisë si vend origjine të ngarkesës, brigjeve të Pulias si një vend hyrjeje dhe aksit rrugor të Kalabrisë si një kanal transiti për Sicilinë", thuhet në raport. Po kështu një element tjetër është edhe rritja e aktivitetit kriminal të trafikantëve shqiptarë të drogës që tashmë po merren veç kanabisit edhe me drogat e forta si kokaina. Autoritet italiane janë alarmuar sepse shqiptarët nga furnitorët të kanabisit janë bërë edhe trafikantët më të mëdhenj të kokainës duke e sjellë vetë nga vendi origjinës në Amerikën Latine për

t'u shitur në Itali, ose për ta shpërndarë më tej në Evropë. Ministri italian në raportin e tij referon për operacionin "Oqeani" ku u arrestuan 18 persona, ku shqiptarët ishin 11 dhe italianët 7, në këtë mes italianët ishin pjesa logjistike e grupit që gjenin baza të fshehta dhe telefona të papërgjueshëm. Grupi kishte dy shefa, një italian dhe një shqiptar, që ishin specializuar në kanabis dhe heroinë. Shqipëria ka kohë që është rruga ballkanike e drogës për familjet mafioze italiane dhe bashkëpunimi me shqiptarët është shumë i vjetër. Por tashmë në familjet mafioze italiane janë infiltruar shumë shqiptarë që po bëjnë karrierë brenda familjeve. E për më shumë tashmë "Cosa Nostra" po ngre edhe bazat e saj në Shqipëri.



GRINDJA PËR JERUSALEMIN NUMËRON TË VDEKURIT

Pas njohjes së Jerusalemit nga SHBA-ja si kryeqytet i Izraelit, si pasojë e trazirave në Jerusalem dhe në territoret palestineze kanë gjetur vdekjen katër palestinezë dhe më se 750 janë plagosur. Shumë prej tyre kanë pësuar plagë prej të shtënave, shumica nga plumba gome, sikurse njofton shërimi palestinez i shpëtimit Gjysmëhëna e Kuqe. Policia izraelite ishte prezente në Jerusalem me trupa të përforcuara. Në Jordanin Perëndimor janë vendosur batalione shtesë të ushtrisë së Izraelit. Intifada e tretë, si dhe e shpalli të premtën "ditën e indinjatës". Në një seancë urgjente në Këshillin e Sigurimit SHBA hasi në kritika masive të 14 anëtareve të këtij forumi. Vendimi i SHBA-së për ta njohur Jerusalemin kryeqytet të Izraelit është "një rast i rrezikshëm precedent", tha ambasadori i Egjiptit të OKB, Amr Abdellatif Aboulatta. Ambasadorët e Britanisë së Madhe Suedisë, Italisë dhe Gjermanisë përmes një deklarate të përbashkët komunikojnë, se ky vendim nuk është në përputhje me rezolutat e

OKB-së dhe nuk është i dobishëm për situatën. Kryenegociatori palestinez Saeb Erekat tha në televizionin Al-Jeezira, se populli i tij do të negociojë sërish me SHBA, vetëm pasi presidenti Trump ta tërheqë vendimin e tij. Pas këtij vendimi, sikurse njoftojnë përfaqësues të lëvizjes Fata, presidenti palestinez Mahmud Abbas nuk do ta takojë nënpresidentin e SHBA-së Mike Pence sipas planifikimit në Bethlehem. Në ndërkohë, Ka përfunduar mbledhja e jashtëzakonshme e ministrave të jashtëm të Lidhjes Arabe e cila u zhvillua në Kajro me kërkesën e Palestinës dhe Jor-

danisë. Këshilli i Ministrave të Jashtëm të Lidhjes Arabe pas takimit publikoi një deklaratë të përbashkët prej 16 pikash. Në deklaratë vihet në dukje se Lidhja Arabe do të vazhdojë takimet dhe se ajo do të mblidhet brenda një muaji për të vlerësuar situatën dhe për të përcaktuar hapat që do të hidhen në të ardhmen në kuadër të zhvillimeve. Në këtë kuadër pritet që samiti i jashtëzakonshëm të mbahet në Jordani, që mban edhe kryesimin e radhës. Gjithashtu në deklaratë bëhet vlerësimi se "Vendimi i njoftuar nga presidenti amerikan, Donald Trump, është i pavlefshëm,

Goma makinash që digjen, gurë që hidhen anë e mbanë: Pas njohjes së Jerusalemit nga SHBA-ja si kryeqytet i Izraelit vendi i shenjtë po tronditet nga trazirat. Në Këshillin e Sigurimit amerikanët po hasin në kritika

është një shkelje e rrezikshme e ligjeve ndërkombëtare dhe të vendimeve të OKB-së si dhe ai nuk ka asnjë fuqi ligjore". Njohja e Kudsit si "kryeqytet të Izraelit" nga Trumpi ka minuar përpjekjet për paqe, ka nxitur tension dhe zemërim si dhe ka shtyrë rajonin në dhunë, kaos dhe paqëndrueshmëri, thuhet në deklaratën.

OKUPIMI GJYSMË SHEKULLOR NË KUDS

Izraeli i cili më 5 qershor të vitit 1967 e okupoi Kudsit Lindor, në vitin 1980 njëanshëm shpalli pjesën lindore dhe perëndimore të qytetit si "kryeqytet i bashkuar". Këshilli i Sigurimit të Kombeve të Bashkuara (KS-OKB) me rezolutën 478 të vitit 1980 nuk e njeht shpalljen e Kudsit si kryeqytet dhe aneksimin e Kudsit Lindor. Në kuadër të vendimit të KS-OKB, komuniteti ndërkombëtar duke përfshirë edhe SHBA-të, pranojnë që Kudsit Lindor është në okupim.

Ambasadat e të gjitha vendeve që njohin Izraelin gjenden në Tel Aviv. Asnjë shtet nuk e pranon si kryeqytet Kudsit ose pjesët lindore dhe perëndimore të qytetit. SHBA-të me veprimin e Trumpit u bë vendi i parë që e njeht si "kryeqytet i Izraelit" Kudsit. Qeveria e Trumpit e cila tërhoqi reagimin e komunitetit ndërkombëtar, injoroi thirrjet në lidhje me atë se rajoni do të tërhiqet në kaos dhe se konflikti izraelito-arab do të bëhet edhe më e pazgjidhshëm.



La bërçollë derri para xhamisë, 15 vite burg për një amerikan

Një amerikan që hyri me forcë dhe dhunoi një xhami në Florida të Shteteve të Bashkuara, u gjet fajtor dhe dënua me 15 vite burg. Michael Wolfe u shpall fajtor për një ngjarje të ndodhur në janar të 2016-s, kur kamerat e sigurisë e filmuan duke thyer xhamat dhe dritaret e xhamisë me një kamë në dorë. Para se të largohej, Wolfe la në derën kryesore të xhamisë një bërçollë derri. 37-vjeçari u akuzua edhe për akuzën e tentativës së vrasjes, që u hodh poshtë nga gjykata, pasi në pamjet e kamerave të sigurisë ai shfaqej vetëm duke vandalizuar xhaminë dhe nuk sulmoi asnjë besimtar.



Trump kalon deri 8 orë në ditë para televizorit!

Presidenti i Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA), Donald Trump, kalon katër orë në ditë para televizorit, ndërsa kjo shprehje e tij, e bën që ndonjëherë të kalojë para televizorit madje edhe tetë orë në ditë. Siç bëri të ditur e përditshmja "New York Times", duke iu referuar burimeve të besueshme të afërta me Trumpin, njeriu i parë i SHBA-ve, çdo ditë kalon rreth katër orë para televizorit. Dita e Trumpit fillon në orën 5:30, ku kryesisht ndjek programin informativ në televizionin Fox News, ndërsa në mesin e programeve të cilat i ndjek rregullisht është edhe "Fox&Friends". Theksohet se Trump ndjek gjithashtu edhe kanalet CNN dhe MSNBC, ndërkohë që telekomanda e televizorit të tij me një diagonale prej 152 cm, përveç nga Trump, mund të preket vetëm nga stafi i tij teknik. Në postimet e tij në Twitter, presidenti amerikan Trump, shpesh kritikon mediat siç janë CNN, MSNBC, "Washington Post" dhe "New York Times", ndërkohë që nuk kursen lëvdatat në llogari të Fox News. Edhe më parë Trump ka qenë në shënjestër të kritikave për pretendimet se kalon shumë kohë para televizorit, në çka kishite thënë: "Në zyrën Ovale nuk shikoj shumë televizion meqë ka shumë dokumente të cilat më duhet ti nënshkruaj, kështu që nuk kam shumë kohë. Këto pohime nuk janë të vërteta".

FËMIJËT JETIMË TË ARAKANIT

Kryetari i Shoqatës Plotësimi i Burimeve dhe Zhvillimit Social (RISDA), Muhammed Nuruzzman, në lidhje me vështirësitë që kanë muslimanët e Arakanit që qëndrojnë në kampet e Bangladeshit tha se "Aktualisht një nga problemet kryesore në kampet e Bangladeshit janë fëmijët jetimë të vetmuar, familjet e të cilëve janë vrarë në Arakan nga ushtria e Mianmarit ose nga budistët fanatikë. Këto fëmijë kanë nevojë për mbështetje". Mijëra muslimanë të Arakanit kanë humbur jetën që nga 25 gushti e deri më tani si rezultat i sulmeve të ushtrisë së Mianmarit, e cila pretendon se është duke luftuar me militantët të armatosur. Gjatë sulme-



ve të cilat janë shndërruar në një spastrim etnik janë djegur ose shkatërruar rreth 300 fshatra nga ushtria dhe budistët radikalë, si dhe mbi 600 mijë muslimanë të Arakanit janë larguar në Bangladesh nëpërmjet rrugëve malore, detare apo të lumenjve. Pavarësisht se muslimanët e Arakanit lar-

gohen në Bangladesh për të shpëtuar jetën e tyre, drama që ata jetojnë për fat të keq nuk përfundon as në vendin fqinj. Sipas të dhënave të Kombeve të Bashkuara, më shumë se 60 për qind e muslimanëve të Arakanit në Bangladesh janë gra dhe fëmijë. Fëmijët që humbën prindë-

rit e tyre në Arakan shkojnë në Bangladesh me muslimanët e tjerë të Arakanit. Theksohet se në kapme ndodhen mijëra fëmijë. Mungesa e higjienës, pamjaftueshmëria e ushqimit, ujit të pastër dhe strehimit, në kampet në Bangladesh kërcënon shëndetin e grave dhe fëmijëve. Muslimanët e Arakanit krahas problemeve të shëndetit vuajnë edhe nga probleme psikologjike për shkak të ngjarjeve të tmerrshme ku ata kanë qenë dëshmitarë në Arakan. Shumë organizata bamirëse ndërkombëtare dhe lokale, veçanërisht organizatat humanitare turke, po përpiqen të ndihmojnë personat që përballen me këto vështirësi në rajon.

Në vitet 1890 Rusia kishte një rol industrial dhe udhëhiqte botën, dhe mendoj që Rusia do të ish bërë vend industrial pa komunistët. Komunistët industrializuan, por vetëm ushtarakisht. Nën komunistët, afro 25% e GDP shkonte për shpenzime ushtarake

Richard Edgar Pipes është ekspert i historisë ruse – veçanërisht Bashkimit Sovjetik. Ai është një akademik polako-amerikan që, në vitin 1976 kryesoi një ekip analistësh të pajtuar nga CIA për të analizuar rrezikun që Bashkimi Sovjetik paraqiste ndaj SHBA. Pipes ka shkruar shumë libra për Rusinë në shekullin 20, si "Komunizmi: Një histori" dhe "Rusia nën regjimin bolshevik".

Po sikur bolshevikët të mos kishin ardhur në pushtet në Rusi?

Kryengritja e bolshevikëve ishte një grusht shteti. Masat nuk ishin aspak të përfshira dhe, në fakt, publiku në përgjithësi nuk dinte që diçka po ndodhte. Nëse lexoni gazetën e asaj kohe, do të shihni që teatrot ishin në punë, kishte koncerte, dhe askush nuk e dinte se çfarë po ndodhte. Ishte tamam një grusht shteti. Kështu që mendoj se, nëse bolshevikët nuk do të kishin marrë pushtetin në nëntor 1917, skenari më i mundshëm është që ushtria – oficerët – do të kishin përmbysur qeverinë e përkohshme dhe do të kishin vendosur ndoshta një lloj diktature ushtarake për pak kohë, deri sa të rikthenin në fron Carin Nikolla II. Mendoj se ky është skenari më i mundshëm.

A mund të ishte ndalur kryengritja e bolshevikëve?


Mendoj që, nëse qeveria e përkohshme që bolshevikët rrëzuan do të kish qenë më efektive, atëherë po, mund të ishte ndaluar. Por problemi ishte se Kryeministri Alexander Kerensky ishte një udhëheqës i dobët dhe nuk dinte si t'i përballte bolshevikët. Kështu që mendoj se po të kish qenë një udhëheqës më i fortë, atëherë bolshevikët do të mund të ndaleshin. Por udhëheqja ishte e dobët dhe Rusia nuk kishte përvojë në qeverisje, sepse kishin qenë prej shumë kohësh nën një autokraci dhe nuk arritën të bëjnë një qeveri efektive. Kerensky, që ndodh ta kem njohur edhe personalisht, nuk dinte si t'i bënte ballë Leninist.

(...)

A do të ishte bërë Rusia gjithsesi një vend komunist, pa kryengritjen e bolshevikëve?

Jo, sigurisht që jo. E vetmja mbështetje që bolshevikët kishin

RICHARD EDGAR PIPES, EKSPERT I HISTORISË RUSE



PO SIKUR KOMUNIZMI TË KISH DËSHTUAR?

për komunizmin në atë kohë ishte se donin paqe, nga Lufta e Parë. Kombi ishte i lodhur nga një luftë që nuk po çonte askund, dhe bolshevikët ishin e vetmja palë që mbronin paqen. Dhe prej kësaj morën një farë mbështetjeje – jo komunizmi si ideologji. Komunizmi nuk ishte asnjëherë një temë e rëndësishme për popullin rus.

Si mendoni se do të kish qenë Rusia pa komunizmin?

Rusia do të kish shkuar ndoshta atje ku është sot, një qeveri gjysmë autokrate dhe gjysmë demokratike. Sipas sondazheve të publikut, rusëve nuk u pëlqen demokracia. Ata e identifikojnë demokracinë me krimin, anarkinë e kështu me radhë. Dhe atyre u pëlqen një dorë e fortë, një udhëheqës i fortë. Kështu që ndoshta do të kishim pasur një regjim autokratik me disa të drejta civile dhe me shumë gjasa, sipërmarrjen private. Ata ndoshta do të kishin rivendosur monarkinë në këtë regjim gjysmë autokratik dhe gjysmë demokratik. Mendoj se do të kish pasur një parlament, siç e kishin para luftës, para revolucionit, që do të kish pasur kompetenca të kufizuara, ndonëse do u duhej të miratonin legjislacionin, por monarkia do të ishte shumë e fortë.

Sa ndryshe do të ishte marrëdhënia e Rusisë me perëndimin, pa komunizmin?

Mendoj se marrëdhëniet do të ishin shumë më mirë, nga sa ishin nën komunistët. Monarkia ruse ishte në përgjithësi miqësore ndaj perëndimit, dhe mësoi shumë prej tij. Nuk ishte antiperëndimore, në fakt Cari Nikolla II dhe Mbreti George V ishin kushërinj. Strategjitë dhe taktikat antiperëndim

u sollën prej komunistëve, sepse ata donin të komunistizimin të gjithë botën, përfshirë perëndimin.

(...)

A ishte komunizmi i rëndësishëm për Rusinë? A e ndihmoi të zhvillohet këtë vend?

Ishte një fatkeqësi në çdo aspekt. Dhjetëra miliona vetë u zhdukën. E vërtetë që ndërtuan industrinë, por pjesa dërrmuese kishin drejtim ushtarinë. Dhe siç mund ta shihni sot, pas gjithë këtyre viteve komunizëm, Rusia nuk mund të eksportojë asgjë përveç lëndëve të para. Nuk shohim mallra konsumi ruse; të gjithë mallrat që importojmë këtu vijnë nga Kina, jo nga Rusia. Përpara kryengritjes së bolshevikëve, Rusia po zhvillohej me shpejtësi drejt një vendi industrial. Në vitet 1890 Rusia kishte një rol industrial dhe udhëhiqte botën, dhe mendoj që Rusia do të ish bërë vend industrial pa komunistët. Komunistët industrializuan, por vetëm ushtarakisht. Nën komunistët, afro 25% e GDP shkonte për shpenzime ushtarake.

A do të kish pasur Rusia një luftë civile në 1918 dhe a do të kish hyrë në Luftën e Dytë Botërore?

Nuk do të kish pasur luftë civile, sigurisht, dhe mendoj që po të mos kish pasur komunizëm, ndoshta nuk do të kish pasur as Luftë të Dytë Botërore, sepse ky konflikt shpërtheu vetëm sepse komunistët në Gjermani ndihmuan Hitlerin të vinte në pushtet dhe në gusht 1939, Rusia i dha atij carte blanche për të nisur një luftë kundër Polonisë, Francës dhe Anglisë. Nuk mund të garantoj që nuk do të kish pasur luftë, por, rusët dihet që ndihmuan Hitlerin të vin-

te në pushtet. Nëse komunistët në Gjermani në vitin 1933 do të ishin reshtuar me social demokratët atëherë do i kishin fituar ata zgjedhjet dhe jo partia naziste. Por Stalini urdhëroi komunistët në Gjermani që të mos bashkëpunonin me social demokratët, kështu që ata përçanë opozitën dhe fitoi Hitleri.

Pa komunizmin, nuk do të kish pasur Rusia figura si Stalini dhe Lenini?

Nuk do të kish pasur as diktatura, as diktatorë të tillë. Rusia, para revolucionit ishte një vend gjysmë kushtetues, por nuk kish diktaturë. Ligjet zbatoheshin dhe parlamenti kish të drejtën e vetos për legjislacionin, por nuk ka krahasim mes asaj që ndodhi para revolucionit dhe asaj që ndodhi pas.

Nëse Rusia nuk do kish qenë duke humbur përballë Gjermanisë në Luftën e Parë Botërore, a do e kishin marrë gjithsesi pushtetin bolshevikët?

Bolshevikët mundën ta marrin pushtetin jo sepse njerëzit donin komunizmin, por sepse ata donin t'i jepej fund Luftës së Parë Botërore, dhe nëse Rusia do e kish fituar luftën mendoj se komunistët nuk do të kishin pasur asnjë shans. Ata e sollën komunizmin në një platformë anti-luftë. Lenini ishte shumë i kujdesshëm të mos propagandonte komunizmin kur erdhi fillimisht në pushtet; ai fliste vetëm për paqe, dhe kur bëri paqe me gjermanët pak muaj pasi mori pushtetin, u bë shumë popullor. Por, e dini, në zgjedhjet për ansamblenë popullore që u mbajtën në nëntor 1917 kur bolshevikët ishin

tashmë në pushtet, ata morën vetëm një të katërtën e votave. Nuk kishin mbështetje të gjerë në vend, dhe aq sa mbështetje kishin, e kishin prej platformës së paqes dhe jo komunizmit. Shumica e publikut ishin për socializmin – për parti të rregullta demokratike socialiste që nuk ishin në favor të diktaturës dhe eliminimit të pronës private e kështu me radhë. Socialistët kishin shumicën në zgjedhjet e përgjithshme.

Pra, mund të thoni që komunizmi iu imponua Rusisë dhe pjesës tjetër të botës?

Lenini kish një synim shumë të qartë, por ai e dinte që nuk mund të krijonte një Rusi komuniste pa e përhapur komunizmin në gjithë botën, prandaj lindi ideja e tij për të përhapur komunizmin, fillimisht përmes Europës, dhe më pas në pjesën tjetër të botës. Ai e dinte që komunizmi vetëm në Rusi nuk mund të funksiononte. Mao Ce Duni në Kinë lartësoi si Leninin, edhe Stalinin, më pas komunizmi nisi në Korenë e Veriut, Kubë e kështu me radhë, por nuk u bë asnjëherë një fenomen mbarëbotëror.

A do të kish pasur luftë të ftohtë me Amerikën në gjysmën e dytë të shekullit 20?

Jo, nuk do të kish pasur Luftë të Ftohtë. Kjo e fundit ishte rezultat i dëshirës së komunistëve për të përhapur komunizmin kudo në botë – dhe në mënyrë të veçantë, të mposhtnin SHBA si rivalin e tyre kryesor. Dua të them, para revolucionit bolshevik, marrëdhëniet mes Amerikës dhe Rusisë ishin shumë miqësore. Mendoj se pa revolucionin marrëdhëniet do të kishin qenë po aq të mira, sa kishin qenë të paktën që nga shekulli 18.

Pra, sipas mendimit tuaj, Rusia në përgjithësi do të kish qenë një vend më i mirë pa komunizmin?

Mendoj se Rusia po zhvillohej shumë mirë para Luftës së Parë Botërore. Kishte problemet e saj – për shembull kish shumë fshatarë dhe jo tokë të mjaftueshme, por këta probleme mund të ishin zgjidhur. Kur partia bolshevike erdhi në pushtet, ata i acaruan të gjithë këta probleme në vend që t'i zgjidhnin.


Dhe a do të ishte Rusia më mirë sot nëse revolucionin bolshevik nuk do të kish ndodhur?

Do të kish qenë shumë më mirë, sipas këndvështrimit tim. Mentaliteti i njerëzve do të kish qenë ndryshe. Mendoj se rusët sot janë shumë konfuzë për atë se kujt i përkasin. Nuk ndihen që i përkasin Perëndimit, por nuk i përkasin as Lindjes, kështu që janë të izoluar. Pa atë revolucion bolshevik që u tha për 70 vite se janë popull unik dhe se janë e ardhmja, do të ishin akomoduar shumë më mirë në botën e sotme.

(BBC History – bota.al)



Meqë preferenca për të shikuar programe sipas kërkesës është në rritje, studiuesit theksojnë se më shumë ekrane po përdoren për më shumë aktivitete tani sesa gjatë studimit, kështu që jo e gjithë koha para ekranit mund të jetë e krijuar si e barabartë



Kujdes me fëmijët, rrezikoni t'i bëni vetë të dhunshëm

Fëmijët që dënohen duke u dhënë një shpullë kanë më shumë gjasa të jenë abuzues ndaj partnerëve në jetën e tyre, thotë një studim i ri. Rreth 800 të rinj janë përfshirë në një studim që dëshiron të tregojë se ata që janë qëlluar kur kanë qenë fëmijë kanë pasur tendencën të jenë agresivë kur të rriten. Studimi zbuloi se të lëndosh fëmijën e çon drejt një sjelljeje më agresive, dhe shumë të rritur që janë të dhunshëm në marrëdhënien e tyre e kanë vuajtur dhunën në fëmijëri. Studimi i universitetit të Teksasit tregon se trendi për tu bërë të dhunshëm kur të rriten i dedikohet gjinisë, moshës, edukimit prindëror, etnisë dhe abuzimeve në fëmijëri. Studiuesit kontrolluan këta faktorë në analizën e tyre dhe kuptuan se ato nuk kanë ndonjë diferencë. Të godasësh fëmijën në formë ndëshkimi është jashtë ligjit në disa vende të botës si Francë, Skoci e Suedi.

SHIKIMI I TEPËRT I TV-së DËMTON TRURIN

Thonë se shikimi i tepërt i televizorit do ta kalbë trurin tuaj. Një studim i ri sugjeron se kjo mund të jetë e vërtetë. Hulumtuesit në Universitetin e Kalifornisë në San Francisko kanë zbuluar në një studim afatgjatë, të publikuar në Journal of the American Medical Association, se shikimi i tri orë ose më shumë televizor në ditë në moshën e hershme të rritur ishte i lidhur me funksionin më të dobët kognitiv në moshën e mesme. Dhe personat të cilët ushtruan më pak, përveç shikimit të tepërt të televizorit, kaluan edhe më keq në testet kognitive, raportuan studiuesit. Aktiviteti fizik është i rëndësishëm për ruajtjen e funksionit kognitiv dhe shëndetit të trurit, kështu që studiuesit nuk ishin të befashuar tërësisht nga rezultatet e studimit, tran-

smeton koha.net. Popullariteti në rritje i dëshirës për të shikuar seri të tëra televizive apo grupe të filmave i ka bërë hulumtuesit të interesohen në lidhje me rezultatet e gjithë asaj kohe para TV në trurin e 25-vjeçarëve pas disa dekadave. "Pyetja është, çfarë do të thotë në qoftë se jeni 50-vjeçar, dhe i keni këto ndryshime të vogla?" tha dr. Kristine Yaffe, psikiatre në Universitetin e Kalifornisë në San Francisko dhe autorja kryesore e studimit, për NPR. "A do të thotë se ju jeni në një rrugë drejt ndryshimeve të mëdha në të ardhmen po kjo nuk e bën ndonjë ndryshim? Nuk mendoj se e dimë vërtetë përgjigjen për këtë".

Kërkuesit i analizuan të dhënat nga 3,247 të rritur të cilët iu bashkuan studimit Coronary Artery Risk Development in Young

Adults (Zhvillimi i Rrezikut të Arteries Koronare tek të Rinjtë) në vitin 1985, kur ata ishin në mes të moshës 18 dhe 30-vjeçare. Mosha mesatare e pjesëmarrësve ishte 25.1, 56.5 për qind ishin femra, 54.5 për qind ishin të bardhë, dhe 92.9 për qind kishin të paktën arsimim të shkollës së mesme. Çdo pjesëmarrës është vlerësuar më shumë se tri herë në mes të fillimit të studimit dhe vitit 2011, kur ai përfundoi. Duke e përdorur Digit Symbol Substitution Test, testin Stroop dhe Rey Auditory Verbal Learning Test, studiuesit zbuluan se personat që shikuan tri ose më shumë orë televizor në ditë - 10.9 për qind e pjesëmarrësve - u ndërlidhën me rënie të performancës kognitive. 16.3 për qind e pjesëmarrësve me aktivitet të ulët fizik gjithashtu kishin re-

zultate më të ulëta në teste. Kombinimi i aktivitetit të ulët fizik dhe shikimit të tepërt të televizorit, gjë që u aplikua në 3.3 për qind të pjesëmarrësve, i dyfishoi shanset që personat të tregojnë funksion të dobët kognitiv në teste.

Mbetet ende e paqartë nëse televizori është shkaku apo efekti i të pasurit një funksion më të ulët kognitiv, theksuan disa studiues, pasi që studiuesit nuk e matën funksionin për pjesëmarrësit në fillim të studimit, dhe efektet e stilit të ulur të jetesës në shëndet janë larg nga të kuptuarit. Shikimi i kufizuar i televizorit dhe aktivitetet që përfshijnë ekrane - studimi nuk e konsideron përdorimin e tabletave dhe smartfonëve për shkak të afatit kohor të tij - në fakt mund të jenë të dobishme, por studiuesit thanë se janë të pasigurt. "Ka shumë më shumë mundësi për t'u ulur tani sa që kjo është edhe më shumë shqetësuese," tha Tina Hoang, studiuese në Veterans Affairs Medical Center në San Francisko, për USA Today. "Nuk ka pasur shumë hulumtime që tregojnë se çfarë do të thonë këto ndryshime të hershme kognitive".

Publicitet

SHMK "Orde Çopella" – Prilep Rr. Samoillova 39 Prilep Tel. 048/422-095

Në bazë të nenit 19, paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores për mënyrën e realizimit të ekskursioneve shkollore për nxënësit e shkollave të mesme, ndërsa në pajtim me nenin 24 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit për arsim të mesëm, Kryetari i komisionit për grumbullimin e ofertave, ndërsa në pajtim me vendimin nr. 02-291 të datës 05.12.2017 për realizim të ekskursionit shumëditor në vitin e III publikon

SHPALLJE Për grumbullimin e ofertave për realizimin e ekskursioneve përfundimtare

SHMK "Orde Çopella" – Prilep në pajtim me programin për realizim të ekskursioneve përfundimtare (shumëditor) për nxënësit e vitit të III në vitin shkollor 2017/2018 dhe mendimin e marrë nga Këshilli i Prindërve dhe Byroja për zhvillim të arsimit organizon:

1. Ekskursion shumëditor përfundimtar me nxënësit e vitit të III jashtë R. M në relacionin **Prilep-Igumenica-Bari ose Brindizi, Napoli-Romë me Vatikan – Milano-Venecia-Veronë – Lido di Jasolo**
Në kërkesën për oferta mund të paraqiten subjekte juridike të cilat i plotësojnë kriteret në vijim:

- të jetë i regjistruar në pajtim me dispozitat pozitive në RM për realizim të veprimtarisë përkatëse turistike.
- të ketë të realizuara me sukses së paku 3 (tre) ekskursione shkollore në 3 (tre) vitet e fundit.
- të plotësojë kushtet për transportim të grupeve të nxënësve, në pajtim me Ligjin për sigurim në komunikacion rrugor dhe Rregulloren për kërkesat e posaçme teknike të makinave me të cilat do të udhëtojnë grupet e nxënësve.

- në çmimin e ekskursionit do të përfshihen shpenzimet për rrugë, ushqim dhe vendosje, të jetë i përfshirë edhe sigurimi themelor ose standard për rrugë pa franshizë.

- të theksohen çmimet për organizim të mbrëmjeve argëtuese.
- ekskursioni do të realizohet në muajin maj në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) ditë me së paku 3 (tre) bujtje edhe atë dy bujtje me mëngjes dhe darkë në Romë dhe një bujtje me mëngjes dhe darkë në Lido di Jasolo.

- kriteret për zgjedhje të ofertës më të mirë janë:
* çmim më i ulët;
* numri më i madh i kësteve të ofruara mujore;
* numri më i madh i udhëtimeve të ofruara falas për nxënësit e prekur social. Ofertuesi i zgjedhur dihet të sigurojë udhëheqës, sigurim për nxënësit dhe person me profesion shëndetësor (mjek). Dokumentacioni tenderues mund të merret nga shkolla në afat prej 5 ditëve nga dita e publikimit të shpalljes në shtypin ditor në zarf të mbyllur me shenjë "Komisioni për grumbullimin e ofertave për ekskursione përfundimtare".

Ofertat e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Kryetari i komisionit
SHMK "Orde Çopella" – Prilep
Biljana Jovanoska

Në bazë të nenit 22 dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 158/10) dhe pëlqimit me shkrim të MASH, Sektori për arsim fillor dhe të mesëm nr. 12-9388/9 të datës 01.12.2017, SHFK "Dame Gruëv" f. Erxhelia, Sveti Nikole, për vitin shkollor 2017/2018 publikon:

SHPALLJE

- Për plotësimin për kohë të caktuar të punës deri më 31.08.2018 për vendet e punës në vijim:
 - Mësimdhënës të **gjuhës maqedonase** 1 realizues me fond jo të plotë të orëve 4 orë, shuma e pagesës bazë 4.128,00 denarë, orari i punës prej ora 07,00 deri në ora 13,00;
 - Mësimdhënës të **gjuhës gjermane** 1 realizues me fond jo të plotë të orëve 12 orë, shuma e pagesës bazë 12.386,00 denarë, orari i punës prej ora 07,00 deri në ora 13,00;
 - Mësimdhënës të **informatikës** 1 realizues me fond jo të plotë të orëve 4 orë, shuma e pagesës bazë 4.128,00 denarë, orari i punës prej ora 07,00 deri në ora 13,00;
 - Mësimdhënës të **matematikës** 1 realizues me fond jo të plotë të orëve 5 orë, shuma e pagesës bazë 5.161,00 denarë, orari i punës prej ora 07,00 deri në ora 13,00;
 - Mësimdhënës të **etikës së religjioneve** 1 realizues me fond jo të plotë të orëve 2 orë, shuma e pagesës bazë 2.064,00 denarë, orari i punës prej ora 07,00 deri në ora 13,00;
 - Mësimdhënës të **etikës** 1 realizues me fond jo të plotë të orëve 2 orë, shuma e pagesës bazë 2.064,00 denarë, orari i punës prej ora 07,00 deri në ora 13,00;
 - Mësimdhënës të **gjeografisë** 1 realizues me fond jo të plotë të orëve 12 orë, shuma e pagesës bazë 12.386,00 denarë, orari i punës prej ora 07,00 deri në ora 13,00;
 - Mësimdhënës të **gjuhës angleze** 1 realizues me fond jo të plotë të orëve 13 orë, shuma e pagesës bazë 13.419,00 denarë, orari i punës prej ora 07,00 deri në ora 13,00;
 - Pedagog** 1 realizues me orar të plotë të punës, shuma e pagesës bazë 20.644 denarë, orari i punës prej ora 07,00 deri në ora 15,00;
- Kandidatët në pikën:
- prej 1.1. deri në 1.9. krahas kushteve të përgjithshme të përcaktuara me Ligjin për marrëdhënie pune duhet ti plotësojnë edhe kushtet e caktuara me Ligjin për arsim fillor (Gazeta Zyrtare e RM nr. 103/08, 49/09, 53/09, 82/09, 88/09, 33/10, 116/10, 156/10, 18/11, 42/11, 51/11, 6/12, 100/12, 24/13,41/14, 116/14, 135/14, 10/15, 98/15, 145/15, 30/16) dhe normativin për kuadrin mësimor dhe duhet të kenë përgatitje pedagogjike-psikologjike dhe metodike në fakultetin përkatës dhe të dorëzojnë dëshmi për të njëjtat.
- Dokumentet e nevojshme (në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter):
 - Fletëparaqitje;
 - Diplomë ose certifikatë për arsimin e mbaruar përkatës;
 - Certifikatë të shtetësisë;
 - Dëshmi për përgatitje të mbaruar pedagogjike-psikologjike dhe metodike;
- Shpallja publike zgjatë pesë ditë pune nga dita e publikimit të saj në shtypin ditor.
- Dokumentet e pakompletuara nuk do të merren parasysh gjatë zgjedhjes së kandidatëve.
- Dokumentet e nevojshme të dorëzohen në emër të SHFK "Dame Gruëv" – f. Erxhelia, Sveti Nikole rr. Marshall Tito nr. 31 për komisionin konkurrues. Tel. 032-459-020.

U. D Drejtor
Aleksandar Ivanovski



Aleksandër Dumas (1802-1870) ishte romancier francez që admironte natyrën shqiptare dhe kulturën e saj. Ishte mjeshtër i përshkrimit të ngjarjeve historike që i vishte me ngjyra letrare. Shkroi veprën madhore "Krime të fshehta" në 3 vëllime, ku trajtohet me hollësi veprimtaria e Ali Pashë Tepelenës dhe natyra shqiptare.

"Tokë shkëmbinjsh, djep trimash dhe njerëz të fortë, – shkruan ai për shqiptarët... kostumi i tyre është më i bukuri në botë, me fustanellën e bardhë si bora e Pindit, me veshjen e mbushur me xhufka të arta, me brezin e qëndisur, ku shfaqeshin një arsenal armësh e thikash.

Hakmarrja dhe dashuria janë pasionet thelbësore të shqiptarëve, për ligj ata kanë shpagimin... Gratë janë të bukura dhe pjellore, por pas martesës ato bëhen pothuajse skllave dhe vihen në punë të rënda, pasi gjithë prodhimet e tokës janë fryt i punës së tyre".

Ai përshkruan personelin shqiptar në oborrin e Ali Pashës, argëtimet e tij me familjen në Butrint. Ali Pashën ai e quan tiran si Neroni i Epirit, (e tejkualuar kjo nga e vërteta historike), por edhe si figurë çlirimtare që i shërben zgjimit dhe çlirimit kombëtar të Greqisë.

ALEKSANDËR DUMAS, ROMANCIERI FRANCEZ QË U MAGJEPS PAS BIJVE TË SHQIPES...

ALI PASHË TEPELENA DHE NATYRA SHQIPTARE

"Tokë shkëmbinjsh, djep trimash dhe njerëz të fortë, – shkruan ai për shqiptarët... kostumi i tyre është më i bukuri në botë, me fustanellën e bardhë si bora e Pindit, me veshjen e mbushur me xhufka të arta, me brezin e qëndisur, ku shfaqeshin një arsenal armësh e thikash

Dumas mendonte shpesh për Shqipërinë e Ilirisë, dëshironte të vinte aty dhe të vihej në krye të shqiptarëve, për të flakur pushtuesit turq nga Shqipëria, Epiri, Thesalia dhe Maqedonia.

Ne do t'i flakim së pari nga këto zona, i shkruante ai të birit, dhe pastaj do t'i shtyjme pushtuesit turq në Stamboll dhe nga Konstandinopoja, padyshim drejt e në Bosfor.

Dumas u lidh me princin e Kastriotëve, ra në marrëveshje me të për një kryengritje dhe Alandro Kastrioti shprehu dëshirën që në krye të kësaj kryengritjeje të ishte Aleksandër Dumas.

Madje në dispozicion të Shqipërisë ai vuri dhe anijen që e mbante pranë pallatit të tij... do të bëj për Shqipërinë atë që Garibaldi bëri për Italinë, – i shkruante shkrimtari një mikut të tij në Paris, nuk më intereson për Napoleonin, por për Shqipërinë dhe Greqinë, për këto vende ku do të luhet fati turk. Shqipëria ishte një nga pro-

vincat më të vështira për t'u shfrytëzuar. Banorët e saj ishin mjaft të varfër, shumë të vendosur dhe nga ana tjetër të fshehur natyrshëm në vargmalet e ashpra. Pashallarët e kishin shumë të vështirë të bënin aty pasuri, sepse secili e kish zakon të mbronte energjikisht bukën e vet.

Muhamedanë apo të krishterë, shqiptarët ishin të gjithë ushtarë. Kur nuk kishin ç'të bënin tjetër mbillnin arën e vet dhe korrnin atë te fqinjët, duke ia marrë sigurisht të lashtat, ose pastaj shkonin e kullosnin bagëtinë, duke gjuajtur rastin për të shtënë në dorë atë të gjitonit. E tillë ishte gjendja normale, jeta e rregullt e Epirit, Tesprotisë, Thesalisë dhe e Shqipërisë së Veriut. Shqipëria e Ulët më pak e fortë, ishte po ashtu më pak aktive dhe më pak e guximshme, dhe atje si në mjaft pjesë të tjera të Turqisë, njeriu i fushës ishte shpesh viktimë e njeriut të malit.

Pikërisht në male ishin ruajtur kujtimet për Skënderbeun dhe ki-

shin gjetur strehë zakonet e Lakonisë së vjetër; ushtari trim i ngjeshin këngë me lirë, kurse kusari i shkathët u tregohej fëmijëve nga prindërit si shembulli më i lartë.

Kishte gëzime që kremtoeshin vetëm më plaçkën që i zihej të huajit dhe gjëja më e mirë e gostisë ishte gjithmonë një dash i vjedhur.

Çdo njeri vlerësohet sipas shkathësisë dhe guximit që kishte, dhe ishte fat i madh të lidhej martesë me dobi kur dikush ndihej si kleft i mirë, apo kusari i mirë.

Shqiptarët, krenarë, e quanin liri këtë anarki dhe me përkushtim fetar kujdeseshin për ruajtjen e një trazire të trashëguar nga stërgjyshërit, duke i siguruar përherë vendin e parë më kreshnikut.

Në kulmin e marrëdhënies së tij kishte qejf ta thoshte hapur se ishte pikërisht ajo e ëma, që e kishte qejf ta thoshte hapur se ishte pikërisht ajo e ëma që e kishte bërë të mbërrinte aty ku ndodhej.

"Gjithçka ia detyroj nënës sime,



i thoshte ai një ditë konsullit të Francës, sepse im atë, kur vdiq, nuk më la veçse një konak e disa ara. Mendja ime e ndezur nga këshillat e saj që më dha dy herë në jetë, sepse më bëri edhe njeri, edhe vezir, më zbuloi fshehtë të fatit që më priste. Që atëherë Tepelena për mua nuk qe veçse trualli i lindjes, nga i cili duhej të lëmohesha për të rënë mbi prenë që e përpunojë në kokë. Ëndërrroja veç për fuqi, thesare, pallate, për gjithçka që koha ka krijuar e më premtonte sepse caku ku kam arritur nuk është fundi i shpresave të mia".

Ajo që binte sidomos në sy në këtë kostum, ishte çallma, pasi rrotullohej dy a tri herë rreth kokës, kalonte poshtë qafës dhe shkante e mbërthehej te pika e vet e nisjes. Veçse kostumi duhej porositur e qepur, e të zbukurohej me qëndisima, gajtane e shirita.

Ai kostum, ende pothuaj i panjohur në Francë, ajo xhoke dhe ata dollakë me kadife të kuqe qëndisur në ar, ajo fustanellë e bardhë si bora, ku nuk mungonte as edhe një palë, ato armë të argjendta gjithë shkëlqim e tërë gdhendje të mrekullueshme, dhe sidomos origjinalitete të mbështjelljes së tokës tërëhoqën gjithë sytë drejt meje.

KODIKËT E BERATIT, NË LIBRARINË DIGJITALE BOTËRORE

Kodiku i Purpurt i Beratit (Codex Beratinus 1) është një dorëshkrim mjaft i rëndësishëm, i shkruar në shekullin VI p.e.s. Ai është dokumenti më i hershëm i gjendur në Shqipëri, është listuar në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO

Kopje digjitale të Kodikëve të Beratit u publikuan në Librarianë Digjitale Botërore të Librarisë së Kongresit të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Kodiku u digjitalizua tërësisht në muajt nëntor-dhjetor 2016 nga Arkivi Qendror Shtetëror në kuadër të bashkëpunimit mes AQSH dhe Librarisë së Kongresit. Ardit Bido, drejtori i Arkivit në intervistën për Zërin e Amerikës, ka folur për këtë projekt



në kuadër të vitit të Skënderbeut si dhe për projektet e tjera që janë planifikuar: "Në vitin mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut ne e nisëm fatmirësisht në Uashington me një promovim ndërkombëtar të pasurisë sonë dokumentare, duke promovuar në Librarianë e Kongresit publikimin e Kodikëve të Beratit. Është thjesht aktiviteti i parë në kuadrin e këtij viti, i cili do të pasohet me shumë aktivitete të tjera, së pari me Javën e Arkivave të Hapura ku do të shihen proceset e

punës në Arkivin Qendror Shtetëror".

Kodiku i Purpurt i Beratit (Codex Beratinus 1) është një dorëshkrim mjaft i rëndësishëm, i shkruar në shekullin VI p.e.s. Ai është dokumenti më i hershëm i gjendur në Shqipëri, është listuar në listën e trashëgimisë botërore të UNESCO dhe ruhet në Arkivin Qendror të Shtetit. Gjithsej ka 190 fletë, të shkruara me shkronja të derdhura në argjend. Bukurshkrimi është i veçantë ndërsa gërmat janë të mëdha (majuscule). Ai përmban

dy ungjij: sipas Mateut dhe sipas Markut. Lënda e dorëshkrimit është pergamenë në ngjyrë të kuqe të thellë (purpurt) prej nga ka marrë edhe emrin. Pjesë të tjera të rëndësishme të kodikut janë të derdhura në ar. Kapaku i dorëshkrimit është më i vonshëm se vepra, ai është metalik dhe me zbulime skenash biblike.

"Kodikët e Beratit janë pasuria më e madhe e trashëgimisë sonë kulturore, një dokument që vjen që nga shekulli VI dhe i ka mbijetuar shekujve, duke u ruajtur me kujdesin më të madh fillimisht në Berat dhe më vonë Arkivin Qendror Shtetëror dhe përbën një tregues të pasurisë Kombëtare Kulturore Shqiptare. Në këtë kuptim digjitalizimi i tyre dhe publikimi në Librarianë Digjitale Botërore të Librarisë së Kongresit është një ndër promovimet më të mira që mund t'i bëjmë trashëgimisë sonë kulturore", ka thënë Bido. Ndërkohë janë rreth 500 milionë dokumente në Arkiv që pritet të

hyjnë në sistemin e digjitalizimit, dhe pritet që në një vit mund të arrihet digjitalizimi i rreth 2.5 milionë dokumenteve. Drejtori i AQSH ka bërë me dije se në total janë 600 mijë dokumente të skanuara në një proces 10-vjeçar. Ndërsa, sa i përket pyetjes mbi vendruajtjen dhe buxhetin që ka Arkivi, Bido ndër të tjera tha: "Është momenti për të dhënë lajmin e mirë sepse tashmë kalojmë buxheti në Kuvendin e Shqipërisë. Për herë të parë shteti shqiptar po i kthen sytë nga arkivat, në thelbin e vet: në vendruajtje. Vendruajtjet arkivore aktualisht janë në një gjendje të mjerueshme. Buxheti i ofruar bën të mundur ndërtimin e një godine tërësisht të re. Është një projekt i cili shkon diku te 2 milionë dollarë në tërësinë e vet, për të strehuar dokumentet të cilat deri sot janë ruajtur në dy ish-kazerma ushtarake në gjendje tërësisht të mjerueshme, me të cilën ne do të dalim nëpërmjet këtij projekti madhor".

Mendo BESIM.

Sigurime MOTORRIKE

Sigurime PASURIE

Sigurime JETË

Mendo


UNIQA

+389 2 3288 800
www.uniqa.mk

SIGURIME
JETË dhe JO-JETË



DASHI 21. mars - 20. prill

Falë mbështetjes që do iu japë Urani, marrëdhënia juaj në çift do jetë më e bukur se disa ditë më parë. Nuk do kërkonin më të dominoni mbi tjetrin dhe do tregoheni më të kuptueshëm. Beqarët nuk duhet të nxitohen për asgjë. Në planin financiar do arrini ta stabilizoni sa më parë situatën.



DEMI 21. prill - 21. maj

Harmonia do mbizotërojë gjatë gjithë kësaj dite në jetën tuaj në çift. Do ndiheni më së miri në krahët e atij që dashuronin dhe nuk do keni asgjë për çfarë të qaheni. Beqarët nuk duhet në asnjë mënyrë t'i mendojnë personat që do takojnë si objekte sepse do zhgënjehen më vonë. Në planin financiar nuk duhet të kryeni transaksione.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Do i kushtoni më shumë rëndësi sot lidhjes që keni krijuar dhe marrëdhënia me partnerin/en do jetë e mrekullueshme. Secili prej jush do i japë shumë dashuri dhe përkrahje tjetrit. Beqarët do i marrin gjërat me qetësi dhe nuk do e kërkojnë me ngulm një person në krah. Financat do jenë të mira.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Marrëdhënia në çift edhe për ju do jetë e tensionuar dhe problematike. Nuk do bini dakord me partnerin/en për disa vendime që duhet të merrni dhe asnjëri nuk do tolerojë. Beqarët ka shumë gjasa të fillojnë një lidhje, por do e mbajnë atë të fshehte. Në planin financiar duhet të vazhdoni t'i menaxhoni me kujdes të ardhurat.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Do keni shumë dyshime mbi partnerin/en tuaj sot dhe do debatonin gjatë gjithë kohës me të. Do bënit mirë të tregoheshit të kujdesshëm sepse një fjalë më tepër dhe çdo gjë do marrë fund. Beqarët do përfitojnë pafund nga liria që kanë dhe nuk do mendojnë aspak për dashurinë. Influenca e yjeve në planin financiar do jetë kontradiktore.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Mos e idealizoni më shumë sesa duhet atë që keni në krah sepse mund t'i hipë vetja në qejf dhe mund të shohë dikë tjetër. Edhe komplimentet duhen bërë me mençuri. Beqarët do bien më në fund në dashuri me personin që iu përshtatet më tepër. Në planin financiar nuk duhet të ndërmerri shumë rreziqe.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Ditë përgjithësisht e qetë dhe pa emocione të veçanta kjo e sotmja për të dashuruarit. Merrni gjërat si t'u vijnë pa menduar për të nesërmen. Beqarëve nuk do iu pëlqejnë aspak të flirtojnë me persona që nuk i njohin dhe do mbeten sërish vetëm. Në planin financiar duhet të merrni të gjitha masat e duhura.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Do e përforconi lidhjen tuaj me partnerin/en sot dhe do mendoni për një të ardhme të largët me të. Tashmë do jeni të sigurtë se ai është personi i duhur për të kaluar jetën. Beqarët do tërheqin shumë persona pas vetes dhe do bëjnë zgjedhjen e duhur. Financat do jenë më të mira se kohët e fundit.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Marsi do ua shtojë edhe më tepër dëshirat seksuale gjatë kësaj dite dhe ju do ndiheni sikur jeni mbi re në krahët e partnerit/es. Ai do iu përgatisë surpriza të njëpasnjëshme në mënyrë që ju të ndiheni sa më mirë të mundeni. Beqarët do kenë takime mjaft interesante. Financat do i menaxhoni me shumë kujdes.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Nëse tregoheni shumë të drejtëpërdrejtë sot me partnerin/en tuaj, si mund edhe të mos e vlerësojë këtë apo mund t'i ngelet hatri. Kujdes me çdo gjë që do thoni. Beqarët do kenë takime pa fund. Plutoni do jetë i pafavorshëm për sektorin e financave, prandaj mos hidhni hapa të nxituara.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Për sa iu përket çështjeve të zemrës, dita e sotme do jetë e mrekullueshme. Do komunikoni gjatë gjithë kohës me partnerin/en tuaj të dashur dhe do zgjidhni çdo keqkuptim. Beqarët do lëvizin çdo gur për ta gjetur personin e duhur dhe do ia arrijnë qëllimit. Nëse harxhoni një pafundësi të ardhurash, financat do kenë probleme.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Dita e sotme do jetë shumë e paqëndrueshme për ata që janë në një lidhje. Debatet me partnerin/en do jenë të zjarra në orët e para të ditës dhe kjo do iu merrzitet jashtë mase. Beqarët do tregohen më të hapur për takime dhe do kenë një ditë plot të reja. Në planin financiar nuk priten vështirësi të mëdha nëse tregoheni të matur.



11 DHJETOR 1803
8 MARS 1869

SHPREHJA E MAGJISTAREVE, ABRA	K	VEPËR E KOMPOZITORIT NË FOTO	XHAMIA E SHENJËTË NË JERUSALEM	KALIUMI	QENDRA E NJË PARTIE POLITIKE				
SULM					KOMUNË NË FRANCË BELGJIANE				GJYNAH
KALON NGA BRENDË JASHTË				LËNG SHERUES UJË (FRËNGJ.)					
SHUMË I MADH, GOXHA (SH. PASHQ.)							U.Ë. AKTORI GIBSON		
AKTRICJA AMERIKANE, LORIN						QYTET NË RUSI KALË SHALE			
BANOR I RUSISË				BOTIM I PËRDITSHËM (KOHA) AZOTI					
GJËJA QË I LHET DIKËJT PËR TARUAJTUR							LIRA E ITALISË		

ZGJIDHJET: P, M, HIME, BERAT, KULLA, TEKS, OTT, RAMA, B, IZ, K, SELIA, ATAK, URUF, DEL, BALSAM, ADALETI, UË, BEKOL, OMSK, RUS, GAZETA, AMANET, LIT.

Sudoku

shumë i lehtë

mesatar

	5	4	1	2		8													
9	7		5																
	3		9		6														
5	8								3	4									
4		7				6				9									
8			2		4					6									
			3			2	7	8											
			6	1				4											

Shumë i lehtë: 654127893, 971583462, 238946751, 589762134, 417835629, 362491587, 895274316, 146359278, 723618945. Mesatar: 682459137, 759123864, 134687925, 497835216, 326741589, 815296473, 2789664351, 541378692, 963512748.

GOOGLE, KAMPIONE EDHE NË SHAH

Google thotë se AlphaGo Zero, programi i saj i inteligjencës artificiale triumfoi në lojën e shahut kundër Stockfish 8. Divizioni "DeepMind" i Google, sektori që është i ngarkuar me ndërtimin dhe avancimin e inteligjencës artificiale, thotë se AlphaGo Zero luajti 100 lojë kundër Stockfish 8, një program i ndërtuar posaçërisht për lojën e shahut, duke mos humbur asnjë ndeshje. Deri para sfidës me Google, Stockfish 8 ishte i pamposhtuar në lojën e shahut. Google thotë se AlphaGo Zero është në gjendje të përvetësojë me shpejtësi lojërat dhe për shahun i është da-



shur pak orë. Ky ishte testi i dytë i inteligjencës artificiale të Google dhe më i vështirë se i pari, që ishte kundër kampionëve njerëzorë të lojës "Go".

KUSH SHEH PORNO, DO TË PAGUHET!

450 milionë përdorues dhe 30 për qind e sasisë së internetit të konsumuar vetëm për të vizituar faqet për të rritur. Këto janë të dhënat për trafikun mujor të faqeve pornografike dhe po sipas këtyre të dhënave, pjesa dërrmuese e përdoruesve vizitojnë platformat që ofrojnë shërbimin e tyre falas, pra pa paguar gjë. Por, të 450 milionë përdoruesit, nga 2018 mund të kenë një arsye më shumë për të vizituar këto faqe. Platforma amerikane Vice.org kërkon ta shfrytëzojë në maksimum "ushtrinë" e vizitorëve, duke i shpërblyer për të parë porno. Bëhet fjalë për krijimin e një valute virtuale, e ngjashme me Bitcoin, por që do të gjenerojë të ardhura vetëm nga vizitorët e faqeve për të rritur. Skema është e thjeshtë, Vice.org kërkon të krijojë valutën virtuale duke përdorur energjinë përlllogaritëse të kompjuterëve që do të lidhen me faqet pornogra-



fike. Pra, sa më shumë kompjuteri të qëndrojnë i lidhur me faqen dhe përdoruesi të jetë aktiv, aq më shumë rritet energjia përlllogaritëse e procesorit, e rrjedhimisht duke gjeneruar më shumë valutë virtuale. E për të nxitur "punonjësit" e saj, Vice.org premton që të ardhurat e grumbulluara nga aktiviteti kompjuterik në faqen pornografike do t'i ndajë dhe një pjesë e këtyre do t'u kalojnë përdoruesve.

Shpallet djathi më i mirë në botë!



Djathi më i mirë në botë është zgjedhur dhe vjen nga Britania e Madhe. Djathi nga Konrvola ka fituar në konkurrencën e 34 shteteve të tjera dhe është shpallur më i mirë

në botë për vitin 2017. Djathi i quajtur "Cornish Kern" është më i mirë se djathi italian "Blu Di Bufala" i cili ka zënë vendin e dytë, i Austrisë "Capellaro" dhe ai Afrikës Jugore "Delewood Hugenot" kanë zënë vendin e tretë, transmeton Telegrafi. Përse ky djathë është më i mirë se të tjerët? Gjykuar sipas krijuesve të tij, këtë djathë e karakterizon fortësia e cila në brendësinë e tij ngadalë shkapërderdhet, mirëpo e zbukuron shija e butë me nota karamelleje. Si duket, ky kombinim ka kaluar shkëlqyeshëm te juria të cilën e përbëjnë prodhuesit e djathit dhe blerësit.



Mjekët largojnë me sukses granatën nga fytyra e ushtarit



Një fotografi e postuar në internet nga spitali ushtarak i Kolumbi-së, tregon imazhin e kafkës së ushtarit kolumbian Leandro Jose Luna me një granatë në fytyrë, të cilën e kishte marrë pas një aksidenti në detyrë. Granata në fjalë u hoq me sukses nga stafi mjekësor në parkun e veturave të spitalit, për shkak të frikës së ajo mund të shpërthente në sallën e operacionit.

NISSAN SJELL TAKSITË QË ECIN VETË



Nissan ka në plan që të vendosë në qarkullim në Japoni taksi pa shofer, duke nisur nga viti 2020. Në këtë aventurë, Nis-

san ka bashkëpunuar me kompaninë teknologjike DeNa, që do të bëjë të mundur që prenotimi dhe pagesa e taksisë të bëhet

vetëm me një aplikacion në telefon. Gjithashtu, klienti do të zgjedhë vetë rrugën që do të përshkojë taksia deri në destinacion.

1419 - Heretiku Nicolaas Serrurier largohet nga Firenca.

1618 - Rusia dhe Polonia nënshkruajnë Traktatin e Dailinos për paqe.

1688 - Arrestohet Mbreti Xhejms II. 1710 - Beteja e Villa Viciosa (Franca mund Habzburgët)

1816 - Indiana shpallet shteti i 19 i SHBA.

1903 - Forcat britanike nën udhëheqjen e MacDonald dhe Young marshojnë në Tibet.

1906 - Presidenti amerikan Ruzvelt dënon abuzimet në Kongo.

1907 - Ndërtesa e parlamentit në Zelandë të Re shkatërrohet nga zjarri.

1917 - Lituania e okupuar gjermane shpall pavarësinë nga Rusia.

1930 - Banka e Shteteve të Bashkuara hapet në Nju Jork Siti.

1937 - Italia largohet nga Lidhja e Kombeve.

1941 - Qeveria holandeze në Londër i shpall luftë Italisë.

1941 - Gjermania dhe Italia i shpallin luftë SHBA.

1946 - Spanja përjashtohet nga OKB.

1946 - Themelohet Fondi për fëmijë (UNICEF).

1979 - Britania e Madhe i dhuron pavarësinë Zimbabvesë.

Kur macet ju shohin drejt e në sy dhe i pulitin ato ngadalë, janë duke u përpjekur t'iu thonë se ju duan.



Truri ynë vazhdimisht parashikon se çfarë do të thonë njerëzit e tjerë, para se ata të hapin gojën.

Në kulmin e vrapiimit, një gatopard kalon më shumë kohë ajër sesa në kontakt me tokën.



BARASPESHA

Një i dehur qëndron shtrirë në rrugë. I afrohet një polic.

- Çfarë po bën aty?
- Kam humbur diçka!
- Çka ke humbur ashtu?
- Baraspeshën!



Edhe armiku juaj më i madh, nuk mund t'ju bëjë kurrë aq keq, sa mendimet tuaja të pakontrolluara.

(Buda)



KALENDARI HISTORIK 11 DHJETOR



A E DINI SE...



BARSOLETA



THËNIA E DITËS